



Mposhtja e egos



2



Imam Komeini



3



MPOSHTJA E EGOS

Imam Komeini

Tiranë, 2014

Titulli: **Mposhtja e egos**

Autori: **Imam Komeini**

Përktheu nga persishtja: Redis SHEKO

E redaktoi: Liseda RAMAJ

Korrektura teknike: Vjollca **KARAJ**

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie **FEZA**

Kopertina: Sabrie **FEZA**

Botoi: Shoqata "**FLLADI**"





Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Parathënie

Njeriu është krijesa më e mahnitshme e Zotit. Ai ka një natyrë të lindur (fitret) dhe personalitet shpirtëror. Ky është privilegji që e dallon nga krijesat e tjera të gjalla. Njeriu është krijesë që mendon e zgjedh. Mendjen e tij e përdor për të zgjidhur problemet që i dalin përpara, me qëllim arritjen e një jete më të mirë. Paralelisht me këtë përpjekje, ai ndërton historinë e jetës së tij. Ai shton njohuritë e trashëguara nga paraardhësit, shtron udhën për brezat e ardhshëm që të zbulojnë të panjohurat dhe të vënë në shërbim natyrën në mënyrën më të mirë.

Mirëpo, gjatë përpjekjeve të njeriut për të realizuar prirjet dhe synimet e veta dhe në përpjekjen për të shfrytëzuar natyrën, lihet në harresë e vërteta e vyer që është thelbi i personalitetit njerëzor. E thënë ndryshe, është harresa e asaj që quhet "*qenia njerëzore*", edukimi dhe pastrimi i tij shpirtëror. Njeriu harron që Krijuesi i Gjithësisë e quajti atë "*Më i nderuari i të gjitha krijesave*." (eshref-e-makhlukat). Transmetohet nga komentuesit e vërtetë të Shpalljes së Zotit, se rreth

njohjes së njeriut, ata kanë thënë: *'Ai që e njuh vetveten, ka njohur Zotin e tij.'*"

Vërtet, vetëharrimi, mospërfillja e shpirtit njerëzor, pavëmendja e njeriut në përsosuritë dhe virtytet morale, janë dhimbje, nga të cilat, vuan pjesa më e madhe e shoqërisë njerëzore. Dominimi i materialistëve, nga njëra anë dhe pamundësia e shkollave dhe e ideve të ndryshme në komentimin rreth së vërtetës së njeriut, nga ana tjetër, e kanë shtuar edhe më shumë largimin nga qenia e vërtetë.

Në këtë mes kanë qenë vetëm proklamuesit e Teuhidit dhe profetët ata që e kanë bërë edukimin e njeriut në harmoni me dritën e arsyes. Ata e kanë udhëhequr shoqërinë njerëzore drejt përsosurive dhe vlerave sublimeve. Revolucioni Islamik u shfaq me përpjekjen e një njeriu të Zotit, në kulmin e mosbesimit të syve të të gjithë botës. Në thelbin e vet, kjo nuk ishte vetëm një lëvizje politike dhe revoltë popullore për përmbysjen e regjimit. Ajo ishte një ringjallje kulturore dhe morale, e cila e drejtoi njeriun e mpirë bashkëkohor në ringjalljen e natyrës së lindur hyjnore (fitrete ilahi).

Themeluesi i Republikës Islamike, në testamentin e tij të përjetshëm, shkruan:

"Në botë, masa e durimit të përpjekjeve, të vuajtjeve, të sakrificave dhe të privimeve përkon me masën e madhështisë së synimeve. Ajo, për të cilën, ju, o komb i nderuar dhe luftëtar, jeni ngritur në këmbë, është synimi më i lartë dhe më





i vyer. Ky synim është ofruar dhe do të ofrohet nga nisja e kësaj bote në përjetësi dhe mbas kësaj bote, në pafundësi. Ai është institucioni hyjnor (uluvuhej-jet) në kuptimin e gjerë të tij dhe në idenë e Teuhidit me dimensionet e larta të tij. Baza e krijimit dhe fundi i tij është në shtrirjen e ekzistencës në shkallët e fshehtësisë (gajbit) dhe të dëshmimit (shuhud). Përpyekja e pasuesve të profetit Muhamed, të gjithë profetëve të mëdhenj dhe eulijave është manifestuar në të tërë kuptimin dhe ka qenë për gjetjen e udhës drejt përsosurisë Absolute (kemalul mutlak) dhe Madhështisë e Bukurisë së pafund. Është ajo që u dhuron nder banorëve të tokës mbi banorët e mbretërive qiellore. Ajo që përfitohet nga banorët e tokës gjatë udhëtimit në të, nuk i ofrohet asnjë krijesë anëmbanë krijimit më të fshehtë dhe më të dukshëm."

Në logjikën e Imam Komeinit, nuk është objektiv konfrontimi dhe hyrja në politikë, madje, as marrja në dorë e pushtetit. Objektiv është dalja fitimtar nga sheshi i luftës. Zoti në Kur'an thotë: **"Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë."**

Objektiv është edukimi i njeriut dhe udhëzimi i tij në rrugëtimin nga bota e dheut drejt Botës së Përtejme.

Objektiv është formimi i shoqërisë dhe krijimi i një ambienti, me të cilin, të adhurohet vetëm Zoti. Dritat e adhurimit, të sinqeritetit dhe të shprehjes së besimit në të fshehtën (gajb), të fshijnë errësirat e pasioneve të kësaj bote dhe t'i bëjnë sytë e njerëzimit të shikojnë nën rrezet e bukurisë së të Vërtetit në shtrirjen e universit dhe

Teuhidit. Kjo arrihet vetëm me pastrim shpirtëror (tezkijetun nefes). Misteri i madhështisë së punës së Imam Komeinit dhe i çudisë së ndikimit të fjalës dhe të mendimit të tij tek ithtarët e tij, duhet kërkuar në vetë këtë realitet. Ata që nuk e kanë dëgjuar dhe nuk e kanë njohur suksesin e Imam Komeinit në mësimin e përballjes me Nefsin dhe nuk e kanë njohur betejën në sheshin e vështirë të “Luftës më të madhe” (xhihadi Ekber), janë të paaftë në perceptimin e natyrës së Revolucionit të Imamit.

“Xhihadi Ekber” (përballja me vetveten)¹ është titulli i këtij libri. Imam Komeini, para se të merrte në dorë flamurin e përballjes politike, ndjekësve të udhës së tij, u mësonte që vija e tij është e ndarë nga ajo e lëvizjeve politike të zakonshme dhe e politikanëve profesionistë. Fitorja e vërtetë në luftë dhe xhihadi politik, ushtarak e ekonomik, i cili nuk do të përftohej ndryshe, vetëm se me Xhihadin Ekber (luftën me vetveten).

Temat e këtij libri, janë citime të deklaratave të Imam Komeinit në qytetin e Nexhefit Eshref, që ai i ka mbajtur në prang të muajit të bekuar të Ramazanit dhe në

¹ Temat e librit “*Xhihadi Ekber*” janë marrë nga udhëzimet e Imamit të madh në seanca të ndryshme gjatë ditëve të qëndrimit në Nexhefin Eshref, të cilat janë shkruar dhe radhitur nga Huxhxhetul Islam ue Muslimijn Sejjid Hamijid Ruhanit.



ditë të tjera drejtuar Hauzeve ilmije². Ata janë rradhitur me përpjekjen e ithtarëve të Imamit dhe që janë shtypur e botuar, herë pas here, përpara fitores së Revolucionit Islamik brenda dhe jashtë vendit. Paralajmërimet prekëse dhe udhëzimet morale të Imamit të madh, në ato ditë të vështira dhe ligështuese, zgjonin entuziasmin e besimit dhe motivet hyjnore tek nxënësit e zotuar. Ai e ndante vijën e lëvizjes nga rruga e atyre që nuk njiheshin me pastrimin shpirtëror (tezkijetun nefis) dhe mbillte farën e singëritetit dhe të besimit në zemrat e kërkuesve të së vërtetës. E gjithë bota ishte dëshmitare e mrekullive të saj në ditët e zjarrit, në ditët e gjakut lutës së grushtit, të armës (në vitin 57), të rekordit të ushtrisë së rinisë së besimtarëve në përshkrimin e udhës së martirizimit, të manifestimeve të papërshkrueshme të monumenteve të luftës dhe të përgjërimeve të Basixhëve në frontet e luftës mbas saj. Tani më, në përvjetorin e katërt të ndarjes nga jeta e atij robi punëmirë (abdu salih), kemi këtë vepër të pavdekshme të shoqëruar me futnota sqaruese. Kemi edhe pjesën e fundit me titull *“Lartësime të përzgjedhura”*, për hulumtuesit e udhës së tij hyjnore.

*Fondacioni i renditjes e i publikimit të veprave
të Imam Komeinit*

² "Hauze ilmije" quhen shkollat e studimit të fesë tek medh'hebi shi'it.

BISMIL –LAHIR-RAHMANIR-RAAHIM

Kaloi dhe një vit tjetër nga jeta jonë. Ju të rinjtë vini duke u plakur, kurse ne pleqtë shkojmë drejt vdekjes. Në këtë vit studimor, ju jeni njohur me nivelin e studimeve dhe keni nxënë mësim shkencor. E dimë se sa keni studiuar dhe në ç'masë i keni ngritur bazat tuaja shkencore. Mirëpo, ç'keni bërë lidhur me pastrimin moral e shpirtëror, me përfitimin e rregullave të Sheriatit dhe të njohurive hyjnore? Ç'hap pozitiv keni hedhur? A s'ju ka rënë ndërmend ndreqja e vetvetes? A keni parë ndonjë program në këtë fushë? Fatkeqësisht, duhet të them që nuk keni bërë ndonjë punë që të bie ndër sy dhe se nuk keni hedhur ndonjë hap të madh në drejtim të ndreqjes dhe pastrimit shpirtëror.





REKOMANDIM DREJTUAR HAUZEVE TË DIJES

11

Burimet shkencore, paralelisht me nxënien e çështjeve shkencore, kanë nevojë për nxënie të çështjeve morale dhe dijeve shpirtërore. Ndihet nevoja e udhëzimit moral, e edukatorit të potencialit shpirtëror dhe e tubimeve konsultative. Gjithashtu, vlerë kanë edhe programet morale dhe përmirësuese, klasat e edukimit dhe të pastrimit shpirtëror, mësimi i njohurive hyjnore etj., të cilat janë destinacion kryesor i misionit të profetëve (paqja e Zotit qoftë mbi ta!). Fatkeqësisht, nëpër qendrat shkencore i kushtohet më pak vëmendje këtyre lloj çështjeve të nevojshme dhe të domosdoshme.

Shkencat shpirtërore sa vijnë e pakësohen dhe frika është se mos qendrat e dijes në të ardhmen nuk do të mund të edukojnë dijetarë morali. Është mirë që juristët (fakihët) e mëdhenj dhe lektorët e graduar, që janë në fokusin e shoqërisë shkencore, përgjatë mësimit dhe hulumtimit, të përpiqen për edukimin e individëve e të përkushtohen edhe më shumë për çështjet shpirtërore dhe morale. Studentët e këtyre qendrave gjithashtu, është e nevojshme të përpiqen në arritjen e cilësive më të merituar dhe t'i japin rëndësi detyrave të mëdha dhe përgjegjësisë serioze që peshojnë mbi supet e tyre.

REKOMANDIM KUSHTUAR NXËNËSVE

Ju që sot studioni në këto qendra dhe doni që nesër të merrni mbi shpatulla udhëheqësinë dhe udhëzimin e shoqërisë, mos përfytyroni se detyra juaj e vetme është të mësoni një grumbull termash dhe shprehjesh. Ju keni edhe një detyrë tjetër: ju duhet që me këto dije ta formoni dhe ta edukoni veten, në mënyrë të tillë, që kur të shkoni në ndonjë vend tjetër, të mund t'i udhëzoni banorët e atjeshëm. Nga ju pritet që kur të dilni nga qendra e jurisprudences fetare, të jeni të pastër shpirtërisht dhe të formuar, që të mund t'i edukoni njerëzit sipas rregullave dhe udhëzimeve morale islame. E, nëse nuk e ndreqët dot veten tuaj në qëndrime shkencore dhe nuk përfituat pastrimin shpirtëror, në çdo vend që do të shkoni, do ta devijoni popullin e do ta bëni pesimist mbi Islamin. Ju keni një detyrë të vështirë. Nëse nuk veproni sipas detyrës suaj nëpër Hauze dhe nuk planifikoni pastrimin tuaj shpirtëror e rendni vetëm pas mësimit të disa shprehjeve që të rregulloni çështjet bazë dhe të jurisprudencës fetare, në të ardhmen, do të jeni dëmprurës për shoqërinë islame. Madje, mundet që të bëheni shkaktarë të devijimit të popullit. Nëse për shkak të veprimeve dhe akteve të sjelljes suaj të padrejtë humbet rrugën e drejtë një person dhe largohet nga





Islami, keni kryer një nga gjynahet më të mëdha dhe është e vështirë t'ju pranohet pendimi. Ashtu sikur një person të udhëzohet në rrugë të drejtë, *"Është më e mirë se ajo mbi të cilën ndriçon dielli."*³, sipas një transmetimi. Përgjegjësia është dhe do të jetë e rëndë. Përgjegjësitë tuaja janë ndryshe nga përgjegjësitë e përgjithshme të popullit. Ka të ngjarë që çështjet që janë të lejuara për popullin e përgjithshëm, të mos jenë të lejuara për ju. Populli nuk pret që ju të kryeni shumë nga punët e lejuara e jo më, sa i përket punëve të ulëta e të palejuara. Nëse këto punë zënë fill nga ju, e bëjnë pesimist popullin lidhur me Islamin dhe me shoqërinë. Dhimbja është këtu: Nëse populli shikon nga ju ndonjë veprim i cili nuk pritet, ata devijojnë nga feja, i kthejnë shpinën pastrimit shpirtëror e jo individit. Ah, sikur t'i kthenin shpinën individit dhe të bëheshin pesimistë ndaj ndonjë individi! Mirëpo, nëse tek ndonjë klerik shikojmë ndonjë veprim të padenjë dhe të pahijshëm, nuk e analizojmë këtë gjë njëloj sikur ndodh ndërmjet biznesmenëve. Ndërmjet tyre gjenden individë të

³ Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: Kur i Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) më dërgoi në Jemen, tha: *"O Ali, mos lufto me asnjë, por vetëm ftoje atë në Islam. Pafsha Zotin, udhëzimi që Zoti i bën dikujt me dorën tënde, është më i mirë për ty, se ajo mbi të cilën dielli lind dhe perëndon. E, ti shtie në dorën tënde miqësinë (të drejtën e trashëgimisë etj.) e tij."* Furul Kafij, vëll. 5, fq. 36, "Kitabul Xhihad", si dhe "Bab ed-dua ilel Islam kablel kital", hadith

padrejtë dhe të devijuar e siç shikohen persona të korruptuar dhe punëkëqinj nëpër zyra, është e mundur që edhe në mesin e klerikëve të jenë një apo disa persona jopunëmirë e të devijuar. Prandaj, nëse një bakall bën një shkelje, thonë që ai është shkelës. Nëse një parfumshitës bën një veprim të shëmtuar, thuhet që ai parfumëshitës është punëkeq. Mirëpo nëse ndonjë klerik bën ndonjë veprim të pakëndshëm, nuk thonë më që ai klerik është i devijuar, por thuhet: Klerikët janë të këqinj! Detyrat e atyre që merren me dijen (Euli Ilm) janë tepër të rënda. Përgjegjësia e dijetarëve është më e madhe se ajo e njerëzve të tjerë. Nëse në "Usul kafi"⁴ dhe në librin "Uesail"⁵, do t'i referoheni kapitujve të lidhur me detyrat e dijetarëve, do të shikoni që aty janë sqaruar detyra të rënda dhe përgjegjësi serioze për ata që merren me dijen (Euli Ilm). Në transmetim është përmendur që kur shpirti arrin në grykë, për dijetarin nuk ka vend më për pendim (teube) dhe në atë situatë nuk pranohet më pendimi i tij, sepse Zoti ia pranon pendimin deri në



⁴ Usulul Kafij, Kapitulli: Mirësitë e dijëes (Fadlul Ilm), kreu: Cilësitë e dijetarëve, përhapja e dijes, ndalimi i të folurit pa dije, shfrytëzimi i dijes, mburrësi dhe krenuesi për dijen e tij, domosdoshmëria e argumentit për dijetarin dhe "babu En Neuadir.

⁵ Uesailu Shia, vëll. 18, f. 9-17 dhe 98-129. Kitabul Kada, kapitulli: Sifatul Kadi, kreu: 4,11 dhe 12.





minutat e fundit të jetës atyre që janë injorantë (xhahilë).⁶

Në një transmetim tjetër është përmendur që injorantit i falen shtatëdhjetë gjynahe para se dijetarit t'i falet një gjynah.⁷ Gjynahi i dijetarit ka më shumë dëm për Islamin dhe shoqërinë. Injoranti, nëse bën një gjynah, ka mjeruar vetëm veten dhe i ka bërë dëm vetëm vetes, por nëse një dijetar devijon dhe zë e bën një punë të shëmtuar, ka devijuar një botë të tërë dhe i ka bërë dëm Islamit dhe dijetarëve të Islamit.⁸ Në transmetim është përmendur se banorët e skëterrës shqetësohen nga aroma e keqe e një

15



⁶ Xhemil ibni Durraxh thotë se ka dëgjuar nga Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: *“Në kohën që shpirti arrin këtu (dhe me dorën e tij bëri me shenjë tek fyti i tij), nuk ka vend më për pendim për dijetarin.”* Pastaj ai këndoi këtë ajet: **“Vërtet, pendimi është për ata persona që bëjnë keq nga padija.”** (“Nisa”, 17). Usulul Kafi, vëll. 1, f. 59, Kitab: Fadlil Ilm (Mirësitë e dijes), kreu: Domosdoshmëria e argumentit për dijetarin, hadithi 3.

⁷ Hafs ibni Kijas thotë se Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“O Hafs, të paditurit i falen shtatëdhjetë gjynahe përpara se të diturit t'i falet një gjynah.”* Usulul Kafi, vëll. 1, f. 59, Kitabu Fadlil Ilm (Mirësitë e dijes), kreu: Domosdoshmëria e argumentit për dijetarin, hadithi 1.

⁸ Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Janë dy grupe nga ymeti që nëse bëhen punëmirë, kombi bëhet punëmirë e nëse bëhen punëkëqinj, kombi bëhet punëkeq. U pyet: ‘Kush janë ata?’ Ai tha: ‘Dijetarët dhe pushtetarët.’* Khisal, babul ithnejn, f. 37. Tuhful Ukul, f. 50.

dijetari, i cili nuk ka vepruar në përputhje me diturinë e tij.⁹

Midis dijetarit dhe injorantit ka shumë dallim në dobinë dhe dënimin ndaj Islamit dhe shoqërisë islame. Nëse një dijetar devijon, ka mundësi të devijojë një komb dhe ta infektojë atë. Dhe nëse një dijetar do t'i përmbahet moralit dhe rregullave islame, do të udhëzojë një shoqëri. Në disa nga qytezat nëpër të cilat shkoja në stinën e verës, vija re që banorët e tyre ishin shumë të edukuar me rregullat e Sheriatit. Çështja qëndronte këtu, se ata kishin një dijetar punëmirë dhe të devotshëm. Nëse një dijetar i ndershëm jeton në një shoqëri, qytet a krahinë, vetë ekzistenca e tij do të sjellë udhëzimin e popullit të asaj zone, ndonëse edhe nuk predikon dhe nuk udhëzon gojërisht.¹⁰ Ne kemi parë persona që prezenca e tyre ka qenë thelb i këshillës dhe i marrjes së mësimave.



⁹ Sulejm ibn Kajs Helali thotë se ka dëgjuar prijësin e besimtarëve të tregonte një hadith nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që ka thënë: *"Dijetarët janë në dy grupe: një dijetar që ka vepruar sipas dijes së vet dhe që ka gjetur shpëtim dhe një dijetar që nuk ka vepruar në përputhje me dijen e vet dhe që është shkatërruar. Vërtet që banorët e zjarrit shqetësohon nga aroma e keqe e dijetarit që nuk ka vepruar në përputhje me dijen e vet."* Usulul Kafi, vëll. 1, f. 59, Kitab: Fadlil Ilm (Mirësitë e dijes), kreu Shfrytëzimi i dijes, hadithi 1.

¹⁰ Imam Sadiku ka thënë: *"Jini thirrës për njerëzit në të mirë jo vetëm me gjuhët tuaja që të shohin prej jush përprjekjen, të vërtetën dhe vetëdijen."* Usulul Kafi, vëll. 3, f. 59, f. 164, kitab: Iman uel kufr, kreu: Es Sidku ue edaul emati, hadithi 10.



Thjesht vështrimi i tyre sjell vetëdijësim dhe zgjim. Sot, në Teheran, me aq sa unë jam informuar, lagjet dallojnë nga njëra-tjetra. Në një lagje ku jeton një dijetar i pastër shpirtërisht gjenden njerëz punëmirë dhe besimtarë. Në një lagje tjetër, në të cilën është bërë imam xhemati, një person i devijuar me çallmë të mbështjellë në kokë, që ka rregulluar për vete dyqane, do vësh re, që ka mashtruar një klan dhe i ka devijuar ata. Është vetë kjo ndytësi, që nga aroma e qelbur e saj, shqetësohen banorët e zjarrit. Kjo është një aromë e keqe, të cilën e akumuloi në këtë dynja dijetari i lig, dijetari pa veprim dhe dijetari i devijuar. Nëse prishet dijetari, prishet edhe bota¹¹

¹¹ Gurerul Hikem, vëll. 7, f. 269.

RËNDËSIA E EDUKIMIT TË VETVETES

Ata që kanë sajuar fe, kanë sjellë rrugëhumbjen dhe devijimin e masave. Shumica e tyre kanë qenë dijetarë. Disa nga ata kanë studiuar dhe janë ushtruar në qendrat e dijes.¹² Kryetari i një prej grupeve ka studiuar në institucionet tona, por duke qenë se studimet e tij nuk u shoqëruan me vetedukim, ai nuk e hodhi hapin në rrugën e Zotit. Ai nuk kishte larguar nga vetja ndytësitë dhe akumuloi gjithë atë poshtërim. Nëse njeriu nuk nxjerr jashtë karakterit të tij ndytësitë, sado që të studiojë, jo vetëm që nuk do t'i bëjë dobi, por do t'i bëjë dëm. Kur dija hyri e njëjlosur në këtë qendër dhe lëshoi degë e gjethe të ndyra, ajo u bë pemë e keqe. Në atë karakter që nuk është i pastruar, dituria është mbulesë terri. Prandaj, e keqja e dijetarit të degjeneruar për Islamin është më e rrezikshmja dhe më e madhja e të gjitha të këqijave. Dituria është dritë, mirëpo në zemrën e zezë dhe të degjeneruar e përhap edhe më shumë



¹² Ndër to mund të përmenden: Muhammed ibn Abdulvehab (themeluesi i sektit të vehabive) dhe Shejh Ahmed Ahsaji dhe Sejid Kadhimi Rashti (themeluesit e sektit Shejkhije) dhe Ahmed Kesruvi e Gulam Ahmed (themeluesi i Kadianizmit) etj.





shtrirjen e territ dhe të së zezës. Ashtu siç e afron dituria njeriun tek Zoti, po ashtu shpirti kërkues i kësaj bote sjell edhe më shumë distancim nga pragu i Zotit.

19

Dituria e Teuhidit gjithashtu, nëse është për tjetërkënd veç Zotit, është nga mbulesat e territ. Sikur dikush ta mësonte përmendsh Kur'anin, qoftë edhe me katërmëdhjetë lexime, por me nijetin për tjetërkënd dhe jo për Zotin, ai nuk do të përfitojë gjë tjetër veç mbulesës dhe largimit nga Zoti i Vërtetë dhe i Lartësuar. Nëse ju mësoni e përpiqeni, ka mundësi të bëheni dijetarë, por duhet të dini se midis “dijetarit” dhe “të pastruarit shpirtërisht” gjendet një distancë e madhe.

I ndjeri Shejh (Zoti qoftë i kënaqur me të!), profesori ynë¹³, ka përmendur se ka thënë: *“Sa e lehtë është të bëhesh Mullah (dijetar shpirtëror) dhe sa e vështirë të bëhesh njeri!”*. Duhet thënë: Sa vështirë të bëhesh Mullah e sa e pamundur të bëhesh njeri!

¹³ Hirësia e tij, Ajatullah Udhma, Haxhi Esh Sheikh Abdul Kerim El Hairij El Jezdij (1275-1355 hixhri kamerij). Ka qenë prej Juristëve të mëdhenj dhe “Merxha taklid” tek shiat në shekullin e katërmëdhjetë të hixhrit. Mori pjesë në leksionet e fakihëve të mëdhenj si Mirza Buzurg Shirazi, Mirza Muhammed Esfahani Feshareki në qytetin e Nexhefit dhe të Samarasë. Në vitin 1340, Hixhri, kameri, shkoi në Kum (Iran). Me këmbënguljen e dijetarëve të Kunit, vendosi të qëndronte në atë qytet dhe themeloi Hauzen Ilmije të Kunit. Ndër veprat e tij janë: Durerul Fuad der Usul, Es salat, En Nikah, Er Rida’a, El Meuarijth, vepra në Jurisprudencë.

Arritja e virtyteve dhe e moraleve njerëzore është prej detyrave tepër të vështira dhe të mëdha që rëndon mbi supet tuaja. Mos pandehni që sot jeni duke u marrë me studimin e shkencave të Sheriatit dhe po mësoni Fikh (jurisprudencën fetare), që është shkenca më e nderuar. Jeni rehatuar dhe keni vepruar sipas detyrave tuaja. Nëse nuk jeni të sinqertë dhe nuk keni për qëllim afrimin me këto shkenca, atëherë këto nuk sjellin asnjë dobi. Sikur studimet tuaja të mos jenë për Zotin, por të jenë për rendjen pas dëshirave tuaja, pas arritjes së posteve dhe nëse këtë udhë e keni nisur për të fituar tituj, keni qepur për vete gjynahin dhe barrën e rëndë të tij. Nëse këto do të jenë për tjetërkënd veç Zotit, atëherë janë gjynah dhe barrë e rëndë për ju. Prandaj, duhet pastrimi shpirtëror dhe devotshmëria, për të mos përfunduar në dënimin e dynjasë dhe të Ahiretit.

Nuk bën efekt vetëm njohja e këtyre shprehjeve. Dija e Teuhidit, gjithashtu, po të mos shoqërohet me kullimin shpirtëror (sefaje nefis) është mundim. Sa të shumë kanë qenë ata, të cilët ishin dijetarë në dijen e Teuhidit dhe që kanë devijuar klane të tëra.

Por, duke qenë se patën devijuar dhe nuk ishin ndrequr, kur hynë në kontakt me shoqërinë, çuan në rrugë të humbur dhe devijim shumë prej tyre. Këto shprehje të thata, nëse janë pa devotshmëri dhe pa pastërti shpirtërore, sa më shumë që të akumulohen në mendje, aq më shumë zgjerohet mendjemadhësia dhe





arroganca. Dijetarit, që ia merr mendjen arroganca, i humbet fuqia të ndreqë veten dhe shoqërinë e i sjell dëm Islamit dhe myslimanëve. Mbas vitesh përfitimi dijesh, shpenzimi fondesh ligjore dhe përfitimi nga të drejtat islame, ky bëhet pengesë e udhës së përparimit të Islamit dhe mjet për humbjen dhe devijimin e njerëzve. Fryt i këtyre mësimëve dhe hulumtimeve në Hauze, bëhet pengesë për përhapjen e Islamit dhe për mosnjohjen e të vërtetave të Kur'anit. Por prania e tij, madje, mund të bëhet pengesë për njohjen e shoqërisë së vërtetë islame dhe e dijetarëve të vërtetë të fesë. Unë nuk them që të mos studioni, por duhet të keni parasysh që nëse doni të jeni një organ i dobishëm dhe efektiv për Islamin e shoqërinë, të udhëzoni popullin e ta fokusoni tek Islami e të mbron bazën e Islamit, nevojitet të konsolidoni dhe të mbani në mbikëqyrje bazën e jurisprudencës fetare. Nëse nuk mësoni e nuk studioni, është e ndaluar të qëndroni në shkollë (medrese). Nuk është mirë të shfrytëzoni të drejtat financiare ligjore që janë të posaçme për nxënësit që mësojnë dijet islame. Sigurisht, në fund të fundit, ashtu siç mundoheni në çështjet e jurisprudencës fetare (Fikhut) dhe parimeve (Usul), gjithashtu përpiquni edhe në udhën e ndreqjes së vetvetes. Çdo hap që hedhim për studimin e dijes, njëkohësisht e hedhim edhe për shtypjen e epsheve, të përforcimit të potencialit shpirtëror, të fitimit të zbukurimeve morale dhe përfitimit të devotshmërisë.



Studimi dhe nxënia e këtyre dijeve, në fakt, është një hyrje në udhëzimin e vetvetes dhe në përfitimin e virtyteve dhe të rregullave e njohurive hyjnore. Mos qëndroni tek hyrja deri në fund të jetës, që të lini rezultatin!

Ju i mësoni këto dije me synimin e një objektivit të lartë dhe të shenjtë, që përbëhet nga njohja e Zotit dhe e përmirësimit të vetvetes. Duhet të planifikoni marrjen e rezultatit të punës suaj. Përpiquni seriozisht për të arritur destinacionin kryesor tuajin. Kur hyni në (hauze), para së gjithash, duhet të merreni me përmirësimin e vetes suaj. Për sa kohë që qëndroni në qendrat e dijes, ndërsa studioni, duhet të përmirësoni vetveten, që kur të dilni nga ato, populli të përfitojë nga veprimet, si dhe nga virtytet tuaja morale të nxjerrin mësim. Ju duhet të merrni mbi supe udhëheqësinë e një bashkësie. Përpiquni që para se të hyni në një shoqëri, të përmirësoni vetveten. Ka shumë gjëra që e kanë mjeruar njeriun dhe e kanë penguar atë nga përfitimi. Njëra prej tyre për disa është kjo mjekër dhe kjo emame (çallma). Nëse dikujt i zmadhohet emameja dhe i zgjatet mjekra, dhe nuk është i purifikuar, e ka të vështirë të vazhdojë studimin e fesë dhe ngelet padobishëm. Ai e ka të vështirë të mposhtë epshin urdhërues për të këqija (nefsi emare) dhe nuk pranon të shkojë në mësimet e askujt.





Shejh Tusi¹⁴, ka shkuar në mësim në moshën pesëdhjetë e dy vjeçare, ndërkohë që në moshën midis të njëzetave dhe të tridhjetave kishte shkruar libra. Ai kishte shkruar librin me titull “*Tehdhib*” pothuaj në këtë moshë, në lëndën *Tahrir*¹⁵. Në moshën pesëdhjetë e dy vjeçare kishte qenë i pranishëm në qendrën e mësimi të të ndjerit Sejjid Murteda¹⁶, që arriti në atë pozitë. Mos e dhëntë Zotit që para arritjes së tipareve të virtytshme dhe konsolidimit të potencialit shpirtëror, njeriut t’i zbardhet mjekra... Punoni sa nuk u është zbardhur mjekra e mendoni për gjendjen tuaj sa nuk jeni vënë në

¹⁴ Ebu Xha’fer Muhamed ibn Hasan Et Tusij (385-460, hixhri), i quajtur ndryshe si “Shejkh et Taife”, është nga dijetarët e famshëm Imamitë. Ai ishte kryetari i juristëve (Fakihëve) dhe apologetëve (Mutekel’limëve) të kohës së tij. Profesorat e tij ishin Shejh Mufidi, Sejjid Murteza, Ibni Gadairi dhe Ibn Abdun Budend. Shejkh është autor i dy librave të famshëm: *Istibsar ve Tehdhib*, të cilët janë prej katër librave kryesorë të Imamitëve. Shejkh Tusi e bëri Nexhefin qendër të dijes Shiite.

¹⁵ Shejkh Tusi e nisi librin *Tehdhib*, që është sqarues i librit “El Mukniah” i Shejh Mufidit, në kohën që jetonte profesori i vet (Shejkh Mufidi, i cili ka vdekur në 413, hixhri). Në këtë kohë Shejkh ishte 26 vjeç.

-*Hyrja e Tefsirit Tibjan*, me pemën e Aga Buzurg Teheranit.

¹⁶ Ali ibn Husejn ibn Musa, i njohur si “Sejjid Murteda” dhe “ilmul Huda” (355-436, hixhri). Është nga dijetarët e mëdhenj të Islamit dhe të Shi’izmit. Shumë nga figurat e Imamitëve, ndër to edhe Shejkh Tusi, kanë përfutur prej tij. Nga ai është Emalij, Edh-Dherijatu ila Usul esh Sheriati, En Nasirijati, El Intisar dhe Esh Shafij.

qendër të vëmendjes së njerëzve. Mos e dhëntë Zoti që njeriut t'i drejtohet shoqëria përpara se ai të ndërtojë vetveten. Ndërtojeni dhe ndreqeni vetveten përpara se t'ju rrëmbehet nga pëllëmbët freri i së drejtës së zgjedhjes. Stolisuni me morale të bukura e largojini nga vetja ultësitë morale. Kini sinqeritet në mësim dhe në hulumtim, që të afroheni te Zoti. Sikur të mos ishte qëllimi i kulluar në veprime, atëherë njeriu do të largohej nga pragu hyjnor. Nuk ka dyshim se ju e keni dëgjuar ndodhinë e “gurit” që u hodh në Xhehennem dhe zëri i tij u dëgjua pas shtatëdhjetë vjetësh. Transmetohet nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se ka thënë: “Ishte një plak shtatëdhjetëvjeçar dhe gjatë gjithë kësaj kohe shtatëdhjetë vjeçare ai ecte drejt Xhehenemit!”¹⁷ Kini kujdes se, pas pesëdhjetë vjetësh më shumë apo edhe më pak, mos fitoni sketerrën me djersën e ballit nëpër qendrat e studimit! Duhet të vrisni mendjen, të hartoni një program në fushën e pastrimit të vetvetes dhe të përmirësimit moral. Përcaktoni një mësues morali për veten. Organizoni mbledhje konsultimi dhe oratorie. Njeriu nuk ka mundësi që ta edukojë i vetëm veten e tij. Sikur Hauzet të jenë të boshatisura nga prania e edukatorit moral dhe e tubimeve për këshilla dhe udhëzim, janë të destinuara të asgjësohen.



¹⁷ Kelematul Meknuneh, i Fejd El Kashani, f. 123.



Dituria e Fikhut (Jurisprudencës) dhe Usulit (Bazat e Jurisprudencës) ka nevojë për mësues, studim dhe hulumtim. Për çdo dije dhe mjeshtëri në këtë botë, është i domosdoshëm mjeshtri dhe mësuesi. Askush nuk bëhet vetë specialist në ndonjë lëndë, nuk bëhet jurist fetar apo dijetar. E, dijet morale, që janë qëllimi i misionit të profetëve dhe nga dijet më delikate dhe të përpikta, nuk paskan nevojë për mësim dhe për mësues?!

Vazhdimisht kam dëgjuar Sejjid Xhelilin¹⁸, që ka qenë mësuesi i moralit të mjeshtrit të Fikhut dhe Usulit, të ndjerit Shejh Ensariut¹⁹ se profetët e Zotit janë

¹⁸ Sejjid Ali ibn Sejjid Muhamed ka vdekur në vitin 1283, hixhri. Ai ishte nga asketët dhe gnostikët më të mëdhenj të kohës së tij. Kishte ixhazet (leje) nga Shejh Ensari dhe Sejjid Husejn, Imami i Xhumasë së Shushterit. Sejjidi, për shumë kohë, në Shushter ishte i prekuar me profesionin e gjyqësisë (kada) dhe lëshimit të dekreteve (ifta). Më pas, emigroi në Nexhefin Eshref dhe atje mori pjesë në mësimin e fikhut të Shejh Ensarit. Shejhu, po ashtu, merrte pjesë në mësimin e moralit (Ahlak) që jepte Sejjidi. Ai ishte zëvendësi i Shejh Ensariut. Mbas ndërrimit të Shejhut u ul në vend të tij në karrigen e mësimdhënies. I ndjeri Sejjid Ali ishte mjeshtri dhe edukatori i Akhund Mulla Husejn Kulij Hamedanit, i cili kishte shumë nxënës. Ai merrej me udhëheqjen e tyre dhe me personalitete të mëdha si: Muzza Xhevad Meleki Tabrizij, Sejjid Ahmed Kerbelai, Shejh Ahmed Behari, Sejjid Ali Kadi Tabrizij dhe Alamme Tabatabai. Që të gjithë këta janë nga të udhëzuarit dhe të edukuarit e shkollës së tij.

¹⁹ Shejkh Murteza Ensarij (1214-1281, hixhri), i quajtur ndryshe si “Khatem el Fukaha uel Muxhtehidijn”. Është nga nipat e Xhabir ibn

ngarkuar me mision profetik që ta edukojnë njeriun, ta formojnë dhe ta mbajnë larg atë nga të shëmtuarat, degjenerimet dhe ultësitë morale. Ata kanë synuar ta njohin atë me virtyte dhe me rregulla të mira. *Jam dërguar që të plotësoj moralet e mira*²⁰ Një dije e tillë, për të cilën, Zoti i Madhëruar pati aq zell, sa që i nisi me mision profetët, nuk qarkullon më në qendrat tona. Asaj nuk i jep rëndësi denjësisht ndokush. Si pasojë e dobësisë së dijeve shpirtërore dhe njohurive në qendrat tona, çështjet materiale dhe me karakter të kësaj bote kanë depërtuar në mesin e dijetarëve të fesë dhe shumë prej tyre janë larguar nga mjedisi shpirtëror dhe kanë harruar se çfarë kuptimi ka të jesh dijetar I fesë. Disa kanë si plan të mësojnë disa fjalë dhe të shkojnë në zonën e vet apo në ndonjë vend tjetër për të siguruar ndonjë vend pune, post dhe pozitë dhe të përfyten me të tjerët! Ashtu siç thoshte dikush: Më lër të mësoj “El



Abdullah Ensariut, shokut të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ai është një nga gjenitë e shkencës së Usulit që i solli një zhvillim të madh këtij arti. Ja disa nga profesorat e tij: Shejh Musa Kashif el Gata, Shejkh Ali Kashif el Gata, Mullah Ahmed Naraki dhe Sejjid Muhamed Muxhahid. Shejh Ensariu ka edukuar Fakihë të mëdhenj, ku ndër ta spikasim Akhund Harasani, Mirzaï Shirazi dhe Mirza Muhamed Hasan Ashtjani. Nga veprat e tij, *Feraidul Usul* (i njohur si *Resail*) dhe *Mekasib* që janë nga librat e shquar mësimorë.

²⁰ Mexhmaul Bejan, komentimi i ajetit të katër në suren “Kalem”.



Lum'atu" e pastaj do të kuptoj se sit ë flas me kryeplakun e fshatit.

Ka mundësi që t'i arrini këto kërkesa epshore dhe dëshira djallëzore, mirëpo nuk keni fituar vetëm se dëm dhe mjerim për veten tuaj dhe për shoqërinë islame. Edhe Muavija ishte kryetar për një kohë të gjatë, mirëpo nuk mori fryt tjetër për vete, veç mallkimeve, urrejtjes dhe dënimit në Botën Tjetër (Ahiretit).

Është e nevojshme ta pastroni shpirtërisht veten, që kur të bëheni kryetar i një shoqërie apo klani, gjithashtu t'i pastroni shpirtërisht edhe ata. Hidhni hapin për përmirësimin dhe formimin e shoqërisë. Qëllimi juaj të jetë shërbimi ndaj Islamit dhe ndaj myslimanëve. Nëse hidhni hapin për Zotin, Zoti i Madhëruar, që është Ndryshuesi i zemrave, i bën zemrat të kthehen nga ju: **"Vërtet ata që besuan dhe bënë punë të mira, Zoti i Gjithëmëshirshëm do t'u japë dashuri."** ²¹

Mundohuni në rrugën e Zotit dhe sakrifikoni, sepse Zoti nuk ju lë pa shpërblim. Nëse nuk e merrni shpërblimin në këtë jetë, do ta merrni në Jetën Tjetër. Aq më mirë nëse nuk u jep shpërblim në këtë botë sepse kjo botë është e pavlerë dhe e pakuptimtë. Të gjitha mundimet, lodhjet problemet, konsideratat në këtë jetë do të marrin fund shumë shpejt dhe do të kalojnë si një ëndërr para syve të njeriut. Kurse shpërblimi i Botës Tjetër është i pambarimtë dhe i pafund.

²¹ "Merjem", 96.



PARALAJMËRIM HAUZEVE

Ka mundësi që duart e përlyera me helmatisje dhe propagandat dashakeqe t'i paraqesin si të parëndësishme programet e moralit dhe ato përmirësuese (reformatore). Ka mundësi që shkuarjen në minber (podium) për të këshilluar, ta paraqesin ndryshe me pozitën e dijes. Duke ia atribuar "minberin" (podiumin) personaliteteve të reformimit dhe rregullimit të hauzeve, ka mundësi që t'i pengojnë ata nga puna. Sot ndoshta, në disa hauze e quajnë turp shkuarjen në minber dhe këshillimin. Harrojnë që prijësi i besimtarëve (paqja qoftë mbi të!) ishte i minberit dhe e këshillonte popullin nëpër minbere, e vetëdijësonte, e sillte në vete dhe e udhëhiqte atë. Edhe imamët e tjerë (paqja e Zotit qoftë mbi ta!) ishin kështu. Mbase elementë misteriozë i bënë këto injektive keqdashëse me qëllim që të çrrënjosin përsosuritë dhe moralet nga hauzet. Si pasojë, hauzet tona të degjenerohen dhe të rrëzohen. Brenda hauzeve të mbizotërojnë klasat, vetëpëlqimet, hipokrizitë dhe mosmarrëveshjet. Individët e hauzeve të hidhen kundër njëri-tjetrit dhe në formacion të ofendojnë, të përgënjeshtrojnë njëri-tjetrin, të ngelen pa prestigj në shoqërinë islame që të huajt dhe





armiqtë e Islamit të marrin nën kontroll hauzet e t'i shkatërrojnë ato. Keqdashësit e dinë që hauzet gëzojnë mbështetjen e njerëzve dhe deri në ditën kur njerëzit do t'i mbështesin ato, s'ka për të qenë e mundur shpërbërja e tyre. Por, atë ditë, që individëve dhe nxënësve të hauzeve, do t'u mungojë baza morale dhe rregullat islame, ata do t'i kundërvihen njëri-tjetrit, do të bien në mosmarrëveshje dhe do të ndahen në disa grupe. Ata nuk do të ishin më të pastër shpirtërisht dhe do të vinin dorë në punë të shëmtuara dhe të pakëndshme. Rrjedhimisht, bashkësia islame do të bëhej pesimiste lidhur me hauzet dhe do të hiqte dorë nga përkrahja dhe mbështetja e tyre. Si rezultat, do të hapej rruga për ushtrimin e forcës dhe e ndikimit të armikut.

Nëse shikoni që qeveritë tremben nga një klerik a nga një Autoritet i Merituar Reference (Merxha) dhe i llogarisin ata, kjo ndodh sepse ata gëzojnë mbështetjen e njerëzve. Në të vërtetë, qeveritë frikësohen nga njerëzit dhe mëtojnë se po të fyejnë, po të guxojnë të bëjnë agresion ndaj ndonjë kleriku (ruhani), njerëzit do të revoltoshin dhe do të ngriheshin në këmbë kundra tyre (qeverive).

Por, nëse klerikët nuk merren vesh me njëri-tjetrin, flasin keq për njëri-tjetrin, nuk janë të pajisur me edukatë dhe me moral islam, do të rrëzoheshin në

shoqëri dhe njëkohësisht, do t'u dilte nga duart populli.²²

Populli pret që ju të jeni klerikë shpirtërorë dhe të pajisur me edukatë islame. Jini me partinë e Zotit! Ruhuni nga rrezëllitjet e jetës dhe manifestimet false të saj. Mos nguroni për asnjë lloj sakrifice në nxitjen përpara të idealeve islame dhe të shërbimit ndaj ymetit islam. Hidhni hapin në rrugën e Zotit të Madhëruar dhe për hir të kënaqësisë së Tij. Mos i kushtoni vëmendje askujt përveçse Krijuesit Një e të Vetëm. Nëse në kundërshtim me pritshmëritë shikojmë që në vend të vëmendjes tek metafizikja, e tërë përpjekja juaj është për këtë botë, atëherë Zoti na ruajtë!

Mos e bëni lodër tuajën Islamin dhe Kur'anin, me qëllim arritjen e synimeve të liga dhe motiveve të ndyra e të turpshme të kësaj bote. Ymeti do të vijojë të bëhet pesimist dhe ju do të jeni përgjegjës. Nëse disa hoxhallarë (shejkha) hauzesh grinden me njëri-tjetrin për motive personale, për arritjen e interesave të kësaj bote, e fyejnë dhe e quajnë të shthurur njëri-tjetrin, bëjnë potenciale me njëri-tjetrin në marrjen e disa punëve, kanë tradhtuar Islamin, Kur'anin dhe i kanë tradhtuar



²² Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Sikur bartësit e dijes ta mbajnë atë ashtu siç e meriton, ata për çdo çast do të duhen nga Zoti, nga melekët dhe robtë e bindur dhe të dëgjuar te Zoti. Por ata e kërkuar dijen për t’ia arritur kësaj bote dhe Zoti u zemërua me ta dhe ata u poshtëruan para popullit.” Tuheful Ukul, f. 201, “Kapitulli i fjalëve të Prijësit të besimtarëve”.





amanetet hyjnore. Zoti i Madhëruar e la si amanet në duart tona fenë e shenjtë islame. Ky Kur'an fisnik është amanet i madh i Zotit dhe dijetarët janë amanetmbajtësit hyjnorë. Ata kanë për detyrë ta ruajnë dhe të mos e tradhtojnë këtë amanet të madh. Mosmarrëveshjet personale të dynjasë janë tradhti ndaj Islamit dhe ndaj Profetit të tij. Unë nuk e di se për çfarë janë këto mosmarrëveshje të shumta. Nëse janë për këtë botë (dynjanë), ju s'ju përket ajo (dynjaja)! Ta zëmë se edhe sikur të gëzonit shijet dhe fitimet e kësaj bote, nuk do të kishte vend për mosmarrëveshje, nëse nuk do të ishit të denjë shpirtërisht dhe nga këto përfitime ju nuk do të fitonin asgjë përvetëm se pelerinën dhe çallmën.

Efekti shpirtëror ka lidhje me metafizikën. Spiritualisti është përfitues i mësimave të gjalla dhe i cilësive konstruktive islame. Ai që e njeh veten si ndjekës dhe shi'ia (pasues) të Aliut, të birit të Ebu Talibit (paqja qoftë mbi të!), nuk është e mundur që t'i kushtojë vëmendje dëshirave të kësaj bote, e jo më, që të krijojë mosmarrëveshje për ato dëshira!

Ju që pretendoni se pasoni të madhin prijës të besimtarëve, të paktën studiojeni sadopak jetën e atij burri të madh dhe do të shikoni se me të vërtetë, nuk po e pasoni dhe nuk po e shoqëroni në asnjë mënyrë madhërinë e tij. Vallë, a dini ndonjë gjë nga asketizmi, devotshmëria dhe jeta e thjeshtë dhe e panjolllosur e madhërisë së tij? A e vini në zbatim? Vallë, a kuptoni

ndonjë gjë nga përballjet e madhërisë së tij me shtypjen dhe padrejtësinë, me dallimet klasore? A e dini mbrojtjen dhe përkrahjen e pangurueshme të tij ndaj të shtypurve, të privuarve dhe vuajtjeve shoqërore? A veproni ndonjë gjë prej tyre? Vallë, kuptimi “shi’ia” është vetëm në mbajtjen e rrobës së jashtme islame?²³ Atëherë, ku është dallimi juaj nga myslimanët e tjerë, të cilët, në këto çështje janë shumë më përpara se shi’iat? Çfarë përparësie keni ju ndaj tyre?

Ata, të cilët, sot i kanë vënë zjarin dhe e kanë mbytur në gjak gjysmën e kësaj bote dhe ata, të cilët i kanë dhënë udhë vrasjes, e kanë bërë me qëllim, sepse duan t’ia kalojnë njëri-tjetrit në grabitjen e popujve dhe në gllabërimin e kapitaleve. Ata duan të gllabërojnë mundin e tyre dhe të vënë nën sundimin e tyre shtetet e dobëta dhe të prapambetura. Prandaj, në emër të lirisë, të ndërtimit dhe të zhvillimit, të mbrojtjes dhe të pavarësisë, të tërësisë territoriale të shteteve, ata ndezin zjarrin e luftës në ndonjë kënd të botës, hedhin me mijëra ton bomba shkrumbuese mbi popujt e pambrojtur.



²³ Sifatush Shiah, i Shejkh Saduk. Gjithashtu, edhe në Biharul Anuar, vëll. 65, f. 83-95 dhe 149-196, Libri “El Ijman uel Kufr”, K. Inne shiah hum ehlu dijnîl hak...”, kreu Sifatush Shiah ue Esnafuhum.” Shpjegimi i dyzet haditheve i Imam Komeinit, hadithi 29.





Kjo grindje, sipas logjikës së të dhënave mbas kësaj bote, duket e drejtë dhe me vend, por mosmarrëveshja juaj prapë nuk ka vend sipas logjikës së tyre. Nëse pyesim se përse ziheni, përgjigja është se duan të marrin një shtet, duan që të kenë kapitalin dhe interesin e atij shteti. Por, nëse ju pyeteni se për çfarë keni rënë në mosmarrëveshje dhe se për çfarë ziheni, çfarë përgjigjeje do të jepnit? Çfarë fitimi keni ju nga kjo botë që të ziheni për të? Të ardhurat tuaja mujore që zotëroni ua japin sipas pagës së përmuajshme. Ato janë edhe më pak se paratë e cigareve të të tjerëve në çdo muaj.

Unë, në një gazetë apo revistë, që nuk më kujtohet mirë, kam vënë re që buxheti që “Vatikani” dërgonte për një prift në Uashington, ishte një shifër shumë e madhe. E bëra llogari dhe pashë që ishte më e madhe se i gjithë buxheti që kanë (hauzetë) shkollat fetare shi’ite. Vallë, a është e drejtë që me këtë jetesë dhe situatë që keni, të ekzistojnë mosmarrëveshje dhe të zini pozicion kundër njëri-tjetrit?

Rrënja e të gjitha mosmarrëveshjeve, që janë pa një qëllim të caktuar dhe të shenjtë, të çon tek dashuria e kësaj bote. Nëse midis jush ekzistojnë të tilla mosmarrëveshje, kjo ndodh sepse nuk e keni nxjerrë nga zemra dashurinë për këtë botë. Duke qenë se interesat e kësaj bote janë të kufizuara, secili garon me tjetrin me qëllim që të sigurojë sa më shumë prej atyre interesave.

Ju doni një pozitë, tjetri gjithashtu, kërkon po atë pozitë. Kështu do të fillojë smira dhe konflikti, kurse burrat e Zotit, të cilët e kanë nxjerrë nga zemra dashurinë për këtë botë, nuk kanë synim tjetër veç Zotit dhe nuk konfliktohen asnjëherë me njëri-tjetrin. E kundërta do të sillte mjerim dhe degjenerim.

Sikur të mblidheshin sot në një qytet të gjithë të Dërguarit e Zotit, kurrë nuk do të kishin mosmarrëveshje me njëri-tjetrin, sepse qëllimi dhe destinacioni është një: zemrat e të gjithëve janë të fokusuara tek i Vërteti i Madhëruar. Sikur veprat dhe aktet tuaja, gjendja e jetës dhe rrugëtimi drejt përsosurisë (suluk) të jetë kështu siç po shihet sot, frikësohuni se mos shkoni nga kjo botë dhe nuk ia dilni të pendoheni e të bëni teube.

Mendoni rrugëzgjidhjen para se ta humbni këtë mundësi nga duart. Hiqni dorë nga këto mosmarrëveshje të rëndomta. A mos janë banorët dy kombesh? A mos medh'hebi (rryma) juaj ka degë të ndryshme? Pse nuk vini në vete? Pse nuk jeni të sigurtë, të drejtë dhe vëllazëror me njëri-tjetrin? Këto mosmarrëveshje janë të rrezikshme, janë degjenerime që hedhin poshtë shkollat fetare, ju paraqesin të pacipë në shoqëri. Këto ndarje në klasa përfundojnë vetëm në dëmin tuaj. Ato nuk sjellin ndonjë fryt për ju, madje përfundojnë në dëm të dinjitetit, të prestigjit të një shoqërie, të një kombi dhe në dëm të Islamit.





Mosmarrëveshjet tuaja, nëse do të rezultonin me degjenerime, do të ishin gjynahe të pafalshme. Ato do të degjeneronin shoqërinë dhe do të shtonin ndikimin dhe sundimin e armikut.

Mbase duart misterioze sajojnë “detyra fetare” me qëllim që të destabilizojnë shkollat fetare shkencore, të krijojnë hipokrizi dhe kundërshtim. Me mjete të ndryshme ato mbjellin farën e hipokrizisë dhe të përçarjes, helmojnë mendjet dhe molepsin intelektet. Me këto detyra fetare, nëpër shkolla, rrëzojnë individët që janë të dobishëm për të ardhmen e Islamit, që të mos i shërbejnë në të ardhmen Islamit dhe shoqërisë islame. Duhet të jeni të vetëdijshtë dhe vigilentë.

Ndonjëherë djalli cakton detyra për njeriun; ndonjëherë epshet dhe dëshira formale, në emër të detyrës fetare e detyrojnë njeriun në punë, e kjo nuk është detyrë fetare që ndokush të fryjë ndonjë mysliman; të flasë keq për vëllain e tij në fe. Këto janë sugjerime të djallit, të cilat e kanë shpënë njeriun në këtë ditë të zezë. Këto armiqësi janë të banorëve të zjarrit: **Kjo do të ndodhë vërtet. Banorët e zjarrit (të Xhehenemit) do të grinden ndërmjet tyre.**²⁴

Në skëterrë ekziston grindje dhe armiqësi. Banorët e skëterrës grinden dhe zihen, gërvishten me njëri-tjetrin. Nëse ju do të ziheni për interes së kësaj bote, dijeni se ia keni përgatitur skëterrën vetes dhe se

²⁴ Sure “Sad”, ajeti 64.

po shkoni drejt zjarrit. Çështjet e Jetës Tjetër (Ahiretit) nuk kanë grindje. Banorët e Jetës Tjetër jetojnë në paqe dhe qetësi me njëri-tjetrin. Zemrat e tyre janë plot dashuri për Zotin dhe robtë e Tij. Dashuria ndaj Zotit sjell dashuri ndaj personave që besojnë tek Zoti. Dashuria e robve të Zotit është vetë hija e dashurisë së Allahut.

Mos e ndizni zjarrin me duart tuaja! Mos e ndizni zjarrin e skëterrës! Skëterra ndizet me veprat dhe aktet e shëmtuara të njeriut. Janë veprat e njeriut kryeneç, ato që ndezin zjarrin. Në një transmetim thuhet: "Kaluam nëpër skëterrë ndërkohë që ishte e shuar"²⁵

Sikur njeriu të mos e ndezë zjarrin me veprat dhe punët e tij, skëterra është e shuar. Në kohën që njeriu vdes dhe kalon nga kjo botë në Botën Tjetër dhe hapen perdet, kupton që: **"Ky është ndëshkimi i veprave të duarve tuaja..."**²⁶ dhe: **"...Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar..."**²⁷ të gjitha veprat që zënë fill nga njeriu në këtë botë, shihen në Botën Tjetër dhe trupëzohen e marrin formë përballë tij: **"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë,**



²⁵ Kur është pyetur për këtë një nga imamët tanë, në lidhje me përmbajtjen e ajetit (Sure "Merjem", ajeti 71.), është përgjigjur: "Ne kaluam nëpër skëterrë dhe e gjetëm atë të shuar". "Ilm el Jekijn", vëll. 2, f. 917.

²⁶ Sure "Ali Imran", ajeti 182.

²⁷ Sure "Kehf", ajeti 49.





e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.”²⁸

Në Botën Tjetër do të pasqyrohen të gjitha veprat, të gjitha punët dhe fjalët e njeriut, thuajse jeta jonë do të filmohet dhe do të tregohet në atë botë dhe nuk do të mund të mohohet.

Të gjitha veprat dhe lëvizjet tona, shoqëruar me dëshminë e gjymtyrëve dhe të organeve, do të na paraqten në atë Botë. **“...e ato do të përgjigjen: ‘Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim...’”²⁹** Përballë Zotit që i ka bërë të gjitha gjërat folëse, nuk mund t’i mohoni dhe t’i fshihni veprat tuaja të shëmtuara. Mendoni pak, jini largpamës, peshojini pasojat e punëve, sillni ndërmend pasojat e rrezikshme, me të cilat do të përballeni; mos neglizhoni ndaj trytnisë së varrit, të botës së ndërmjetme (Berzakh), të problematikave dhe vështirësive që e pasojnë atë. Së paku, besojeni skëterrën (Xhehenemin). Sikur njeriu t’i besonte me të vërtetë këto pasoja të rrezikshme, ai do ta ndryshonte stilin e tij të jetesës. Nëse ju besoni dhe keni bindje në këto gjëra, nuk do të jetonit kështu pa fre dhe në liri. Ruajeni penën, hapin dhe gjuhën tuaj dhe përpiquni për ndreqjen dhe pastrimin e vetes suaj.



²⁸ Sure “Zelzele”, ajetet 7-8.

²⁹ Sure “Fusilet”, ajeti 21.

PËRKUJDESJET HYJNORE

Prej përkujdesjes së Zotit të Madhëruar është mirësia që Ai u dhuroi atyre. Është arsyeja dhe aftësia e pastrimit shpirtëror. Ai i dërgoi profetët dhe eulijatë (miq të dashur të Tij) që t'i udhëzonin njerëzit për t'u ndrequr, që të mos kaploheshin nga dënimi i dhembshëm i skëterrës. Nëse këto masa e paraprirje nuk do të sillnin vetëdijësimin dhe pastrimin shpirtëror të njeriut, Zoti i Gjithëmëshirshëm e vetëdijëson atë nëpërmjet udhëve të tjera. Ai i ballafaqon njerëzit me halle të ndryshme, varfëri dhe sëmundje. Ai përpiket si një mjek me përvojë dhe infermier i shkathët e i dhembshur, që ta mjekojë këtë njeri të sëmurë nga sëmundja e rrezikshme shpirtërore. Robit, kur është nën mbikëqyrjen e të Vërtetit, i dalin këto halle që ta kthejë vëmendjen tek Zoti i Madhëruar dhe të pastrohet shpirtërisht. Kjo është rruga tjetër veç kësaj, por njeriu duhet ta përshkojë me këmbët e tij këtë udhë, që të marrë rezultat. Edhe sikur të mos sigurohet rezultati nga kjo udhë, sikur të mos mjekohet njeriu i sëmurë e sikur të mos marrë meritimin e begative hyjnore, Zoti e mundon gjatë agonisë dhe dhënies së shpirtit, që ta





kthejë vëmendjen tek Ai. Nëse sërish nuk ka efekt, Ai i sjell dënim në varr dhe në Botën e Ndërmjetme (alemul Barzakh), që pas kësaj të pastrohet dhe të mos shkojë në skëterrë. Të gjitha këto janë përkujdesje nga ana e Zotit të Madhëruar. Nëse nuk mjekohet me tërë këto përkujdesje të së Lartësuarit, si mund t'i bëhet? Detyrimisht, vjen radha e ilaçit të fundit, që padyshim, është vetë djegia. Ka të ngjarë që njeriu të mos pastrohet e të mos ndreqet, të mos i bëjnë dobi këto mjekime dhe në këtë mënyrë nuk mbetet mjet tjetër veçse Zoti i Gjithëmëshirshëm ta ndreqë robin e Tij në zjarr. Është njësoj si floriri, i cili duhet kulluar e duhet pastruar në zjarr.

Në ajetin: **"...që aty të mbeten përgjithmonë."** (labithine fijha ehkabe)³⁰ është transmetuar që ky "hukb", që ka kuptimin e periudhës kohore, është për të udhëzuarit dhe për ata që e kanë ruajtur thelbin i besimit.³¹ Ky është për mua dhe për zotërinë tënde, nëse jemi besimtarë. Se sa mijëravjeçar është çdo "hukb", Zoti e di. Mos ndodhtë që këto ilaçe të efektshme të mos bëjnë më dobi për meritimin e Xhenetit të begatë! Mos

³⁰ Sure "Nebe", ajeti 23.

³¹ Ajashi përcjell me zinxhir transmetimi nga Hamrani, se ka thënë: E pyeta imam Sadikun (paqja qoftë mbi të!) rreth këtij ajeti: **"...që aty të mbeten përgjithmonë."** (labithine fijha ehkabe). Ai tha: "Ky ajet është për ata që dalin nga zjarri." Mexhmaul Bejan, vëll. 10, f. 424, tefsiri i sures "Nebe".

lindtë nevoja për ilaçin e fundit që njeriu të shkojë në skëterrë e të digjet në zjarr, që të pastrohet nga ultësitë morale, ndytësitë shpirtërore dhe cilësitë e shëmtuara djallëzore! Njeriu pastë meritë të dobishme nga **"...kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj..."**³² Kjo është sa u përket asaj kategorie njerëzish, prehëri i gjynahit të të cilëve, nuk është shtrirë në atë gradë sa të zhvishen tërësisht nga mëshira dhe përkujdesja e të Vërtetit, por ata ende kanë meritë për të shkuar në Xhenet. Zoti mos e dhëntë, që njeriu të largohet e të refuzohet nga pragu hyjnor si pasojë e gjynaheve dhe të privohet nga mëshira hyjnore! Frikësohuni se mos mbeteni të privuar nga mëshira dhe përkujdesja hyjnore dhe bëheni shkak i zemërimit e i ndëshkimit të Tij. Ju, tani, nuk jeni në gjendje të mbani, qoftë edhe për një minutë, një gur të nxehtë në pëllëmbë të dorës, prandaj ruhuni nga zjarri i skëterrës! Derdhini jashtë nga Hauzet dhe nga shoqëria këto zjarre! Largojini nga zemrat tuaja këto mosmarrëveshje dhe hipokrizi! Silluni mirë, me edukatë dhe me dhembshuri me krijesat e Zotit! Vështrojini ata me butësi dhe mëshirë! Sigurisht, mos jini të mirë me mëkatarët për shkak të mosbindjes dhe të rebelimit të tyre! Kini kujdes veten nga trazirat, kaosi dhe anarkia! Bëjini mirë robve të mirë dhe pundrejtë të Zotit! Respektojini ata që janë dijetarë për hir të dijes së tyre! Respektojini ata që janë në rrugë të udhëzimit për



³² Sure "Muxhadele", ajeti 22.



hir të veprave të tyre të mira dhe respektojini ata që janë injorantë dhe të paditur meqenëse janë rob të Zotit! Silluni mirë me ta, jini të mëshirshëm, të ndershëm e vllazërorë me ta! Ju doni të udhëhiqni një shoqëri.

41

Dikush që nuk mund të ndreqë dhe të drejtojë veten e vet, si kërkon të udhëheqë e të drejtojë të tjerët?! Tani nuk kanë mbetur, vetëm se disa ditë nga muaji Shaban. Përpiquni që brenda këtyre ditëve të keni sukses në pendim dhe në ndreqjen e vetvetes e me shendet shpirtëror të hyni në muajin e bekuar të Ramazanit!



DISA PIKA NGA MUNAXHATI SHABANIJE

(përgjërimi i muajit Shaban)

Në këtë muaj Shaban, a nuk e keni lutur aspak Zotin e Madhëruar me Munaxhatin Shabanije³³, që është rekomanduar të këndohet nga fillimi deri në fund të muajit? A keni përfituar nga kontekstet e saj të larta dhe shembullore në besimin dhe në njohjen më të madhe të pozitës së Zotit? Në lidhje me këtë lutje është përmendur se ky është përgjërimi i të madhit prijës të besimtarëve (paqja e Zotit qoftë mbi të!), i bijve të tij dhe e të gjithë imamëve të pastër (paqja e Zotit qoftë mbi ta!), të cilët e lusnin Zotin me atë.³⁴

Shihen disi rrallë ato lutje dhe përgjërime, për të cilat është komentuar, se që të gjithë Imamët (paqja qoftë mbi ta!) e kanë kënduar dhe i janë përgjëruar Zotit me të. Ky përgjërim, në fakt, është një hyrje në drejtim të

³³ Ikbalul A'mal, A'malu sherhr Sha'ban, f. 685. Misbahul Mutehexhid ue silahul muteabi, f. 374. Biharul Anuar, vëll. 91, f. 97-99, kitabu Dhikri ued dua, el babu 33, hadithi 12.

³⁴ I njëjti burim.





vetëdijësimit dhe të përgatitjes së njeriut për të pranuar detyrat e muajit të bekuar të Ramazanit. Mbase bëhet për t'i sjellë ndërmend njeriut të vetëdijshëm motivin e agjërimit dhe motivin e frytit të tij.

Imamët e pastër (paqja e Zotit qoftë mbi ta!) shumë çështje i kanë sqaruar në formën e lutjeve. Gjuha e lutjeve dallon shumë me gjuhët e tjera që kishin ata figura të larta e që me to shpjegonin rregullat (ahkam). Më së shumti, ata shpjegonin çështjet shpirtërore, çështjet metafizike, rregullat e përpikëta hyjnore dhe atë që lidhet me njohjen e Zotit, e kanë shpjeguar me gjuhë lutjeje. Është për të ardhur keq se ne i lexojmë lutjet kalimthi dhe nuk i kushtojmë vëmendje këtyre kuptimeve. As nuk e kuptojmë qëllimin e imamëve me këto lutje. Në këtë përgjërëm, lexojmë: *"O Zoti im, më dhuro ndërprerjen e plotë për te Ti! Ndriçoji sytë e zemrave tona me ndriçimin e syve që shikojnë në Ty, derisa sytë e zemrës të grisin perden e dritës, derisa të arrijnë në vetë madhështinë e dritës dhe shpirtrat tanë të bëhen të varur në lartësinë e madhëstisë Tënde."*

Kjo fjali: *"O Zoti im, më dhuro ndërprerjen e plotë për te Ti!"* (Hebli kemalel inkitai ilejk), ndoshta është kallëzuese e kuptimit që burrat e vetëdijshëm të Zotit, duhet ta përgatisin veten përpara mbërritjes së muajit të bekuar të Ramazanit për agjërëm. Në fakt, është shkëputje dhe mënjanim nga kënaqësitë e kësaj bote. Ky mënjanim është vetë shkëputje për tek Zoti. Shkëputja e

plotë (kemale inkita) nuk arrihet kaq thjeshtë. Ajo ka nevojë të jashtëzakonshme për ushtrim, mund, disiplinë, rezistencë dhe praktikë, që të tjerët, veç Zotit (sivallah), të mund të shkëputen nga ne dhe ne të mos e kthejmë vëmendjen në gjë tjetër veç Zotit.

Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Në muajin e bekuar të Ramazanit të gjithë njerëzit janë të ftuar në mikëpritjen e Zotit të Madhëruar dhe janë miq të Krijuesit të tyre.”* dhe: *“O njerëz! Vërtet, tek ju po vjen muaji i Allahut dhe ju jeni të ftuar në mikëpritjen e Allahut.”*³⁵

Mendoni për këto pak ditë që kanë mbetur para se të vijë muaji i Ramazanit, ndreqeni veten dhe kthejeni vëmendjen tek Zoti i Madhëruar, kërkon falje për aktet dhe sjelljet tuaja të pakëndshme! Nëse keni kryer ndonjë gjynah, pendohuni përpara se të hyni në muajin e bekuar të Ramazanit!

Mësojini gjuhët tuaja me përgjërimin drejtuar Zotit të Madhëruar! Mos përgojoni e mos shpifni! Në këtë muaj jeni ftuar në sofrën e Tij. Përgatiteni veten për gostinë madhështore të të Vërtetit të Madhëruar. Së paku, jini të qëndrueshëm në rregullat formale të agjërimit (Rregullat reale janë një kapitull tjetër, të cilat lypin mundim dhe vigjilencë të përhershme).



³⁵ Uesailu Shiia, vëll. 7, f. 227, kapitulli i agjërimit, "Ehkamu Saum, kreu 18, hadithi 20.



Kuptimi i agjërimit nuk është vetëm për vetëpërmbytje dhe kursim në të ngrënë e në të pirë. Njëkohësisht, duhet përmbytja edhe nga gjynahet. Këto janë nga rregullat elementare të agjërimit që janë për fillestarët (Rregullat e agjërimit për burrat e Zotit që duan të arrijnë minierën e madhështisë janë të tjera).

Veproni sipas rregullave elementare. Ashtu siç ruani barkun nga të ngrënë dhe të pirë, ashtu ndalojini sytë, veshët e gjuhët nga gjynahet. Vendosni që tani që të ruani gjuhën nga përgojimi, nga shpifja, nga sharja e gënjeshtër. Nxirrni nga zemra mërinë, smirën dhe cilësitë e tjera të shëmtuara djallëzore. Sikur të mundni, arrijeni shkëputjen për Zotin, bëjini veprat tuaja me sinqeritet dhe pa hipokrizi.

Shkëputuni nga djajtë, nga njerëzit e nga xhindet. Por, siç duket, jeni të dëshpëruar nga arritja e një lumturie të vyer. Së paku, përpiquni që agjërimi juaj të mos jetë i ndërmjetësuar me gjëra të ndaluara. Në të kundërt, edhe sikur agjërimi juaj të jetë i saktë ligjërisht, e nuk është i pranuar nga Zoti, ai nuk shkon lart. Pranimi i një vepre ka shumë dallim me saktësinë ligjore.

Nëse me përfundimin e muajit të Ramazanit, në veprat tuaja nuk ndodhi asnjë ndryshim, e rruga juaj nuk bëri dallim nga ajo e mëparshmja, përpara muajit të agjërimit, del në pah që nuk është realizuar agjërimi që

u kanë kërkuar. Ajo që keni kryer, ka qenë agjërime përgjithësisht shtazor.

Në këtë muaj të nderuar, në të cilin jeni ftuar në mikpritjen hyjnore, nëse nuk keni njohje ndaj të Vërtetit apo nuk u është shtuar njohja, dijeni që nuk keni hyrë drejt në gostinë e Zotit (dijafetullah) dhe nuk e keni çuar në vend të drejtën e mikpritjes. Në muajin e bekuar, që është muaji i Zotit (Shehrrullah), dyert e mëshirës hyjnore janë të hapura për njerëzit. Sipas transmetimeve,³⁶ djajtë janë të prangosur dhe të lidhur me zinxhirë. Nëse ju nuk mund ta ndreqni veten, nuk mund ta futni nën mbikëqyrjen dhe nën kontrollin tuaj epshin (nefsu emare), nuk mund të nënshtroni pasionet e të ndërpritni lidhjet tuaja me botën e materializmit, pas përfundimit të muajit të agjërimit, është e vështirë që të mund t'i vini në zbatim këto çështje. Prandaj, shfrytëzoheni rastin para se të kalojë kjo begati madhështore. Ngrihuni në pozitën e ndreqjes, të pastrimit të çështjeve tuaja.

Përgatiteni veten për kryerjen e detyrave të muajit të agjërimit. Nganjëherë njeriu gjynahqar, si pasojë e largësisë nga i Vërteti dhe si pasojë e mëkateve



³⁶ Transmetohet nga Xhabir nga Ebu Xha'fer (paqja qoftë mbi të!) se i Dërguari i Allahut kthehej me fytyrë nga njerëzit dhe thoshte: "O njerëz. Kur hyn muaji i Ramazanit, djajtë prangosen, hapen dyert e qiellit, hapen dyert e Xheneteve, hapen dyert e mëshirës, mbyllen dyert e zjarrit dhe lutja pranohet." Uesailu Shiia, vëll. 7, f. 224, kapitulli i agjërimit, kreu 1, hadithi 14.





të shumta, zhytet aq shumë në errësirë dhe padije, saqë nuk ka më nevojë për cytjet e djallit dhe shfaqet vetë në ngjyrën e tij³⁷. "Sibgetullah" (ngjyra e Allahut) është antonim "sibgetu shejtan" (ngjyra e djallit.)

Ai që rend pas epshit dhe e ndjek djallin, gradualisht, merr ngjyrën e tij. Merrni vendim, që së paku, në këtë muaj, të mbikëqyrni veten tuaj, të mënjanoheni nga fjalët dhe aktet me të cilat Zoti nuk pajtohet. Që tani, në këtë kuvend, jepini besën Zotit tuaj që në muajin e Ramazanit, do të vetpërmbaheni nga përgojimi, nga shpifja dhe nga sharja e të tjerëve.

Nënshtrojeni gjuhën tuaj, sytë tuaj, duart, veshët dhe gjymtyrët e organet tuaja. Mbikëqyrini veprat dhe fjalët tuaja. Ndoshta, vetë ky veprim i denjë, motivon që Zoti i Madhëruar t'u kushtojë vëmendje dhe t'u japë sukses.

Mbas kalimit të muajit të agjërimit, kur djajtë të çlirohen nga zinxhirët, ju të jeni ndrequr dhe të mos mashtroheni nga djalli. Në këto tridhjetë ditë të muajit të bekuar të Ramazanit të bëni kujdes me gjuhën, me sytë, me veshët dhe me të gjitha organet e gjymtyrët tuaja. Përherë të keni mendjen se ç'gjykim dhe ç'rregulla merr nga ana ligjore fetare veprimi që doni të kryeni, fjala që doni të thoni dhe tema që jeni duke dëgjuar.

³⁷ Frymëzuar nga ajeti 138 i sures "Bekare": "...S'ka "ngjyrë" më të bukur se ajo që jep Allahu! Ne vetëm Atë adhurojmë!"

Këto janë rregullat parësore të agjërimit. Së paku, përmbajuni këtyre rregullave të agjërimit. Po të shihni që dikush kërkon të përgojojë, dilini përpara dhe tregojini se jeni të angazhuar që në këto tridhjetë ditë të Ramazanit të vetëpërmbaheni nga punët e ndaluara. Edhe sikur të mos mund ta ndaloni atë nga përgojimi, ikni nga ajo ndjenjë. Mos u ulni t'i dëgjoni. Myslimanët duhet të jenë të sigurt nga ju. Në të vërtetë, nuk është mysliman ai, nga dora, nga gjuha dhe syri i të cilit, nuk janë të sigurtë myslimanët e tjerë. Ai është mysliman vetëm në dukje dhe vetëm shqiptues i thënies "*La ilahe il'allah*".³⁸

Nëse silleni pa edukatë, ofendoni dhe përgojoni dikë, dijeni që jeni në praninë hyjnore (para syve të Zotit), jeni mysafirë të Zotit të Madhëruar. Në prani të të Vërtetit ju po silleni keq me robtë e Tij. Fyerja e robit të Zotit është fyerja ndaj Zotit. Këto janë rob të Zotit. Ndonjëherë, shikon që njeriu nëpërmjet këtyre gjërave, arrin deri aty, sa në kohën e vdekjes, përgënjeshtro



³⁸ Imam Bakiri (paqja qoftë mbi të!) ka transmetuar se i Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "A t'ju njoftoj për besimin? Besimtar është dikush, të cilit, besimtarët i zënë besë atij për jetën dhe pasurinë e tyre. A të mos ju vë në dijeni për myslimanin? Mysliman është dikush, nga i cili, myslimanët janë të sigurtë nga gjuha dhe nga dora e tij." Usul kafi, vëll. 3, f. 331. "Kitabe ijman ve kufr" (libri **Besimi dhe Mosbesimi**) kapitulli elmumin ve alametuhu ve sifatuhu" (besimtari me shenja dhe tiparet e tij) hadithi 19.



Zotin. Ai bëhet mohues i ajeteve të Zotit³⁹. Këto punë vijnë gradualisht. Sot, një shikim jo i drejtë, nesër, një fjalë - përgojim, ditën tjetër, një fyerje ndaj myslimanëve etj., pak e nga pak, e nxijnë zemrën dhe e pengojnë njeriun nga njohja e Zotit (marifetullah). Njeriu arrin deri aty, sa i mohon të gjitha gjërat dhe i përgënjeshton realitetet. Sipas disa ajeteve dhe komentimit të disa transmetuesve, veprat e njeriut i paraqiten të Dërguarit të Zotit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe imamëve të pastër dhe kalojnë para shikimit të tyre.⁴⁰

³⁹ **Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe (Xhehenemi), ngase i mohonin shpalljet e Allahut dhe talleshin me to.** (Sure "Rrum", ajeti 10.)

⁴⁰ Ashtu siç theksohet në ajetin 105 të sures "Teube": **Thuaj: "Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë."** Ebu Basiri ka transmetuar nga imam Sadiku se ka thënë: Veprat e njerëzve punëmirë dhe punëkeqë, çdo mëngjes paraqiten tek i Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), prandaj kini kujdes. Vetë ky është kuptimi i fjalës së Zotit të Lartësuar: **Thuaj: "Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. "Usul Kafij", vëll. 1, f. 318, "kitabul Huxhxheh" bab ardul a'mal ala nebij uel eimeh (a.s)", hadithi 1, 2-6. Tefsir *Burhan*, vëll. 2, f. 157.**

Sa do të shqetësohet Profeti i nderuar kur të hedhë vështtrimin dhe të shikojë veprat tuaja me gjynahe? Mos kërkonin që të shqetësohet dhe të preket i Dërguari i Zotit. Kur të vështrojë Profeti i nderuar që faqja e punëve tuaja është plot me përgojime, shpifje e sharje në lidhje me myslimanët; kur të vështrojë se e gjithë vëmendja juaj është e përqendruar tek kjo botë dhe materializmi, kur të vështrojë se zemrat tuaja valojnë nga inati, smira, armiqësia dhe pesimizmi ndaj njëri-tjetrit, ka mundësi që të turpërohet përpara Zotit të Madhëruar dhe melekëve të Tij (melaiketullah). Ka mundësi që kombi (ymeti) dhe pasuesit e tij kanë qenë mosmirënjohës në lidhje me begatitë hyjnore dhe kështu të shfrenuar e padruajtje kanë tradhtuar amanetet e Zotit të Madhëruar. Edhe një individ që lidhet me një individ tjetër dhe nëse është shërbëtor i tij, po të bëjë ndonjë shkelje, ai ndihet i turpëruar. Ju jeni të lidhur me të Dërguarin e Zotit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Duke u futur në qendrat e dijes apo seminare, ju i lidhët vetet tuaja me jurisprudencën islame, me Profetin më të nderuar dhe me Kur'anin fisnik. Po të kryeni ndonjë punë të shëmtuar, kjo e rëndon Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Zemra e njeriut është si një pasqyrë e kulluar dhe e ndriçuar. Ajo verbohët si pasojë e vëmendjes së jashtëzakonshme ndaj kësaj bote dhe mëkateve të shumta. Nëse njeriu e kryen me sinqeritet dhe pa





hipokrizi agjërimin për Zotin e Madhëruar (nuk them që të mos jenë të sinqerta adhurimet e tjera, është e nevojshme që të gjitha adhurimet të kryhen me sinqeritet dhe pa hipokrizi); nëse njeriu është mospërfillës i epsheve dhe mënjanohet nga kënaqësitë e kësaj bote dhe shkëputja nga të tjerat veç Zotit, atë mund ta përfshijë përkujdesja hyjnore dhe do t'i pastrohet pasqyra e zemrës nga nxirja; mbase do t'i lind shpresa që ai të shmanget nga bota natyrale dhe kënaqësitë e saj dhe kur të hyjë në "Natën e Kadrit" do të marrë shkëlqimet që janë atë natë për të dashurit e Zotit (eulijatë) dhe besimtarët (muminët). Shpagimi i një agjërimi të tillë është Zoti, ashtu siç ka thënë: **"Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për atë."**⁴¹ Shpërblim i një agjërimi të tillë janë kopshtet e begatshme (Xheneti Naim). Ky shpërblim nuk mund të llogaritet. Sikur njeriu në emër të agjërit, të mbyllë gojën ndaj ushqimeve dhe ta çelë atë për të përgojuar njerëzit me ofendime për myslimanët, ai nuk do të sjellë ndonjë ndikim. Një agjëruer i tillë ka nëpërkëmbur të drejtën e Mbikëqyrësit të begatisë së tij (velinimet), Mbikëqyrësit të begatisë që përpara se të krijonte njeriun, përgatiti për të të gjitha mjetet e përsosurisë, dërgoi profetët për udhëzim dhe u dha fuqi atyre për ta shpënë njeriun në

⁴¹ "Furuul Kafij", vëll. 4, f. 63, "kitab es sijam", "bab maxhae fi fadli saum ves saim", hadith 6.

minierën e madhështisë dhe në dritën e lumturisë më të madhe.

Ai Krijues i ka dhuruar arsyen, ka bërë bujari e tani i ka ftuar robtë e Tij që të hyjnë në shtëpinë e Tij të pritjes dhe të ulen në sofrën e begatisë së Tij. Vallë, a është e drejtë që robtë të marrin nga sofa e begatisë së Tij, nga mjetet dhe nga shkaqet lehtësuese që ka vënë në dispozicion të tyre, të kundërshtojnë Kujdestarin dhe Mikpritësin e tyre dhe të ngrenë krye kundra Tij? A është e drejtë që robtë t'i vënë në punë kundra Tij dhe përkundër dëshirës së Tij mjetet që Ai ua dhuroi atyre? A nuk është kjo një mosmirënjohje, që njeriu të ulet në krye të sofrës së Zotërisë së Tij dhe të fyejë me veprat e pahijshme dhe të paedukata të tij Mikpritësin e respektuar? Ai është Kujdestari i begatisë së njeriut. Miku duhet të njohë Mikpritësin dhe të mësojë për pozitën e tij, të njihet me rregullat dhe ritualet e ambientit, të përpiket që nga ai të mos dalë ndonjë veprim amoral dhe pa etikë. Miku i Zotit të Madhëruar duhet ta njohë pozitën hyjnore të madhërisë së Tij. Profetët e mëdhenj të Zotit dhe imamët (paqja e Zotit qoftë mbi ta!) gjithnjë kanë rendur pas njohjes së kësaj pozite. Ata dëshironin që të kishin dorë në këtë lloj miniere drite dhe madhështie. *Ndriçoji sytë e zemrave tona me ndriçimin e syve që shikojnë në Ty, derisa sytë e zemrës të grisin perden e dritës, derisa të arrijnë në vetë madhësitinë e dritës dhe shpirtrat tanë të bëhen të varur në lartësinë e*





madhështisë Tënde." Mikpritja e Zotit (ziafet allah) është vetë "miniera e madhështisë". Zoti i Madhëruar i ka ftuar robtë e tij për të hyrë në minierën e dritës dhe të madhështisë, por nëse robi nuk e meriton, nuk mund të hyjë në një pozitë të tillë madhështore. Zoti i Madhëruar i ka ftuar robtë në të gjitha mirësitë dhe në shumë nga kënaqësitë shpirtërore, por nëse ata nuk do të tregojnë gatishmëri për të qenë të pranishëm në të tilla pozita të larta, nuk mund të hyjnë në to.



MBULESAT E NJERIUT

Vëmendja tek të tjerët veç Zotit e mbulon njeriun me mbulesë “errësire” dhe “drite”. Tërësia e çështjeve të kësaj bote, nëse bëhet motiv i vëmendjes së njeriut për këtë botë dhe pavëmendshmërisë së tij ndaj Zotit të Madhëruar, sjell errësirë. Të gjithë faktorët truporë janë mbulesa errësire. Dhe, nëse kjo botë është mjet i vëmendjes tek i Vërteti dhe i arritjes në Botën Tjetër, që është “Bota e Nderit” (*Daru teshrif*), mbulesat e errësirës shndërrohen në mbulesa drite. Shkëputja e plotë (*Kemalul inkita*) është heqja mënjane e të gjitha mbulesave të errësirës dhe të dritës, që të arrihet hyrja në Mikpritjen Hyjnore, që është “Miniera e Madhështisë”. Prandaj, në këtë përgjërëm i kërkojmë Zotit të Madhëruar ndriçim për zemrën, me qëllim që të arrihet grisja e mbulesave të dritës dhe të arrihet hyrja në minierën e madhështisë, duke thënë: *derisa sytë e zemrës të grisin perden e dritës, derisa të arrijnë në vetë madhëshinë e dritës*.

Ai njeri, që ende nuk i ka grisur mbulesat e errësirës, vëmendjen e tij e ka të përqendruar në botën natyrore. Ai është i devijuar dhe në thelb nuk ia ka idenë se çfarë gjendet pas natyrës dhe nuk e njeh botën shpirtërore. Ai është me natyrë të mbrapshtë dhe kurrë nuk ia ka arritur që të pastrojë veten. Ai nuk ka përfutur



nga fuqitë shpirtërore që të heqë mënjanë perdet e zeza, të cilat kanë hedhur hije mbi zemrën e tij. Ai gjendet në fundin e fundit (esfele safilin), që është mbulesa e fundit e errësirës: **"Pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët."**⁴²

Zoti i Gjithëditur dhe i Plotfuqishëm e krijoi njerun në gradën më të lartë: **"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer."**⁴³ Ai njeri që pason epshin e tij dhe që kur e ka njohur veten nuk interesohet për asgjë tjetër, veç botës së errët të natyrës, ai nuk mendon kurrë që përveç kësaj bote të papastër dhe të errët gjendet edhe një vend i ngushtë dhe një Botë Tjetër. Për këtë e shohim atë të zhytur në mbulesat e errësirës. Një njeri i tillë është vërtetësi e thënies së Allahut: **"...por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta..."**⁴⁴ Vërtet, për shkak të zemrës së njollosur me gjynahe e të mbuluar me perden e errësirës, për shkak të pasimit të epsheve dhe të dëshirave, të cilat ia kanë verbuar syrin, ai njeri nuk mund të çlirohet nga mbulesat e errësirës dhe jo më të grisë mbulesat e dritës dhe të fitojë shkëputjen e çdo gjëje tjetër veç Zotit.

Sigurisht, nëse ai beson, besimi i tij nuk duhet të mohojë pozitën e të dashurve të Zotit (eulijauallah). Të

⁴² Sure "Tijn", ajeti 5.

⁴³ Sure "Tijn", ajeti 4.

⁴⁴ Sure "Araf", ajeti 176.

mos i quajë legjenda: Botën e Ndërmjetme (Alemul Barzakh), Urën e Siratit, Ringjalljen, Llogarinë, Librin, Xhenetin dhe Xhehenemin. Vërtet, njeriu, si pasojë e gjynaheve dhe dhënies pas kësaj bote, fillon t'i mohojë gradualisht këto realitete. Ai mohon pozitën e të dashurve të Zotit, edhe pse pozita e tyre nuk është vetëm kjo që përmendet në disa fjali që gjenden në lutje dhe në përgjërime.





DIJA DHE BESIMI

57

Ndonjëherë vërej se në këto realitete ka dije, por nuk ka besim. Ai që lan të vdekurit nuk frikësohet nga i vdekuri, sepse ka bindjen që i vdekuri nuk është më në gjendje të reagojë. Ai nuk bënte dot ndonjë gjë kur ishte gjallë dhe kur kishte shpirtin në trup, e jo më tani që e ka zbrazur trupin. Frikësimi nga i vdekuri ndodh sepse ata nuk besojnë tek ky realitet. Ata kanë dije për Zotin dhe për Ditën e Shpagimit, por nuk kanë bindje. Zemra nuk ka njohuri për atë që percepton arsyeja.

Sipas fakteve, ata e dinë që është një Zot dhe që ka për të ndodhur një Ringjallje (Miad) dhe katrostrofë (Kiamet), mirëpo vetë ky fakt logjik ka mundësi që të bëhet mbulesë zemre dhe të mos lejojë që drita e besimit të ndriçojë mbi zemër, që Zoti i Madhëruar ta nxjerrë atë nga errësirat dhe ta fusë në botën e dritës: **“Allahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë. Sa për ata që nuk besojnë, mbrojtësi i tyre është djalli, i cili i nxjerr ata nga drita dhe i shpie në errësirë. Këta janë banorët e Zjarrit (të Xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”**⁴⁵

Dhe, ai, të cilit Zoti i Madhëruar i është bërë kujdestar dhe e ka nxjerrë nga errësirat, ai nuk bën

⁴⁵ Sure “Bekare”, ajeti 257.

gjynahe më, nuk përgojon më, nuk shpif më, nuk ka smirë dhe nuk mban mëri ndaj vëllait të tij në besim. Ai ndjen ndritje në zemrën e tij, nuk i jep vlerë kësaj bote dhe asaj çfarë gjendet në të, ashtu siç ka thënë i madhi prijësi i besimtarëve (*paqja qoftë mbi të!*): “Sikur të më jepnin botën dhe gjithçka që gjendet në të, që të merrja me forcë dhe padrejtësisht lëkurën e elbit (*drithe*) nga goja e një milingone, kurrë nuk do ta pranoja.” ⁴⁶

Por disa prej jush, nëpërkëmbin gjithçka. Ata përgojnë figurat e mëdha të Islamit. Nëse të tjerët shajnë dhe përgojnë bakallin ose ndonjë tjetër, ata shpifin padrejtësisht ndaj dijetarëve të Islamit, ofendojnë dhe shkelin mbi ta, sepse nuk u është ngulitur besimi dhe nuk i besojnë ndëshkimit të veprave dhe akteve të tyre. Dhe fjala “ismet” nuk ka ç’të jetë tjetër veç besimit të plotë. Kuptimi i “ismet” për profetët dhe të dashurit e Zotit nuk është se Xhebraili i merr për dore dhe i udhëzon se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë nuk duhet të bëjnë.

Sigurisht që, sikur Xhebraili të merrte për dore Shimrin⁴⁷, kurrë nuk do të bënte gjynah! Por “ismet” ka lindur prej besimit. Sikur njeriu të kishte besim tek i Vërteti dhe ta shikonte me sytë e zemrës si diell Zotin e Madhëruar, do të ishte e pamundur të bënte gjynahe.

⁴⁶ Nehxhul Belagah, “Ligjërata” 215.

⁴⁷ Shimr ibn Dhil Xheshen është kriminel i preu kokën imam Huseinit në Kerbela (Sh. P.)





Ashtu sikurse shfaqet “ismeti” përpara një të fuqishmi të armatosur, është edhe vetë frika nga besimi në prani, ajo që e ruan njeriun nga rënia në gjynah.

Të pamëkatët (masumijn) (*paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) mbasi që u krijuan nga dheu i pastër, si rredhojë e ushtrimeve shpirtërore dhe e pajisjes me morale të larta, e shikojnë gjithnjë veten në prani të Zotit të Madhëruar, që i do të gjitha gjërat dhe është i informuar mbi të gjitha punët. Ata besojnë në kuptimin “La ilahe il-lall-llah”; besojnë që përveç Allahut, gjithkush dhe gjithçka është e zhdukshme dhe nuk mund të luajë rol në fatin e njeriut.

“Mos adhuro zot tjetër, krahas Allahut! S’ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij! Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës (Qenies) së Tij! Atij i përket vendimi dhe tek Ai do të ktheheni të gjithë!”⁴⁸

Sikur njeriu të krijonte bindjen dhe të besonte që të gjitha botët e dukshme dhe të padukshme janë prani hyjnore (mahzare Rububi) dhe se Zoti i Madhëruar është i Pranishëm dhe Mbikëqyrës kudo, pra, me praninë e të Vërtetit dhe me begatinë e të Vërtetit, nuk është e mundur të bëhet gjynah. Njeriu nuk bën gjynah përpara një fëmije që është në gjendje t’i dallojë gjërat; ai nuk zbulon pjesët e turpshme. E si ndodh që i zbulon pjesët e turpshme përpara të Vërtetit dhe pranisë hyjnore, e nuk nguron para kurrëfarë krimi?!

⁴⁸ Sure “Kasas”, ajeti 88.

Kjo ndodh sepse ai beson në praninë e fëmijës, ndërsa edhe sikur të ketë dijeni për praninë hyjnore, ai nuk ka besim. Si pasojë e gjynaheve, me të cilat është nxirë zemra e tij, nuk mund t'i pranojë kurrë këto lloj çështjesh dhe realitetesh. Në fakt, nëse njeriu dyshon – s'është nevoja të ketë bindje – janë të vërteta këto lajme që janë sjellë në Kur'anin fisnik dhe premtimet e kanosjet e bëra që të rishikojë veprimet dhe aktet e tij, e nuk merr kot më kot ashtu i shfrenuar.

Sikur ju të dyshonit që përgjatë udhës mund të gjendet ndonjë egërsirë që mund t'ju sjellë dëm apo të ketë qëndruar ndonjë person i armatosur që mund t'ju sulmojë, do të vetëpërmbaheshit nga të përshkuarit e asaj udhe dhe do të qëndronit. Ju do të viheshit në pozitën e hetimit të saktësisë dhe të pasaktësisë së saj.

Vallë, a mundet që dikush të hedhë dyshimin për ekzistencën e skëterrës dhe të përjetësisë në zjarr, e megjithatë të bëjë shkelje? Vallë, a mund të thuhet se dikush e konsideron Zotin të Pranishëm dhe Mbikëqyrës, e shikon veten në praninë hyjnore dhe hedh dyshimin që gjendet shpagim për fjalët dhe veprat e tij? A mund të thuhet se dikush e beson se ka dhënie llogarie dhe ndëshkim dhe që në këtë botë regjistrohet çdo fjalë që thotë, çdo hap që hedh dhe çdo veprim që bën? A mund të thuhet se dikush që e konsideron Zotin të Pranishëm dhe Mbikëqyrës dhe e shikon veten në





praninë hyjnore, nuk beson se melekët e Zotit (melaiketullah) janë Rakib-i dhe Atid-i?

“Dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”⁴⁹

61

Ata e mbikëqyrin atë dhe ia regjistrojnë të gjitha fjalët dhe veprat. E, ndërkohë të mos ketë frikë në kryerjen e shkeljeve? Dhembja është këtu, se vërtete nuk ka dyshime mbi materializimin e këtyre realiteteve. Nga rruga, metoda dhe cilësia e rrugëtimit shpirtëror (suluk) të disave, arrihet në konkluzionin që ata as që japin gjasa mbi ekzistencën e botës metafizike, sepse thjesht dhënia e gjasës, mjafton që njeriu të frenohet nga shumë punë të pahijshme.



⁴⁹ Sure “Kaf”, ajeti 18.

HAPI I PARË DREJT PASTRIMIT SHPIRTËROR

Deri kur do të vazhdoni të flini dhe të zhyteni në degjenerim dhe prishje? Frikësohuni nga Zoti. Ruhuni nga pasojat e punëve. Zgjuhuni nga gjumi i neglizhencës. Ju ende nuk jeni zgjuar, ende nuk e keni hedhur hapin e parë. Hapi i parë është metoda (suluk) e zgjimit, por ju po vazhdoni të flini. Sytë i keni të hapur, kurse zemrat thellë në gjumë.

Sikur të mos i kishit zemrat e nxira nga gjynahi, nuk do të vijonit kështu mendjefjetur dhe indiferentë me fjalët dhe punët tuaja të padrejta. Sikur të mendonit sadopak për çështjet e Botës Tjetër dhe pasojat e tmerrshme të saj, do t'i jepnit më shumë rëndësi detyrave dhe përgjegjësi që keni mbi supe.

Për ju është edhe Ringjallja dhe Kiameti. Ju nuk jeni si krijesat e tjera që nuk kanë rikthim . Pse nuk merrni mësim? Pse nuk zgjoheni dhe të vini në vete? Por, me mendje të fjetur vazhdoni të përgojoni dhe të shani vëllezërit tuaj myslimanë. A nuk e dini se kjo gjuhë që zgjatet për përgojim, ditën e Kiametit do të dërrmohet





nën këmbët e të tjerëve? A e dini se *"Përgojimi është ushqim për qentë e zjarrit"*?⁵⁰

A nuk e keni menduar ndopak se ç'fund të keq kanë këto mosmarrëveshje, këto armiqësi, smira, pesimizma, vetëpëlqime dhe mendjemadhësi? A nuk e dini që fundi i këtyre punëve të poshtra dhe të ndaluara është skëterra. Ka mundësi që përfundimi të jetë me përjetësi në zjarr. Mos e dhëntë Zoti që njeriu të sëmuret me sëmundje pa dhembje. Sëmundjet që kanë dhembje e shtyjnë njeriun t'i drejtohet mjekut dhe spitalit, ndërsa sëmundja që është pa dhembje dhe që nuk ndihet është shumë e rrezikshme. Këtë njeriu e merr vesh vetëm atëherë, kur çdo gjë ka marrë fund. Sikur sëmundjet psikike të kishin dhembje, sërish do kishte vend për falënderim.

Në fund të fundit, do ta shtynte njeriun për t'u kuruar, por çfarë të bësh që këto sëmundje të rrezikshme nuk kanë dhembje?! Sëmundja e mendjemadhësisë dhe e vetëpëlqimit nuk ka dhembje. Gjynahe të tjera e degjenerojnë dhe e prishin pa dhembje zemrën e shpirtin. Këto sëmundje, jo vetëm që nuk kanë dhembje, por gjithashtu, në dukje, sjellin kënaqësi. Mbledhjet dhe



⁵⁰ Është përmendur në këshillat e prijësit të besimtarëve (paqja qoftë mbi të!) për Neuf El Bekalij: Largohu nga përgojimi, sepse atë nuk e hanë as qentë e skëterrës." Uesaliush Shiah, vëll. 8, f. 600, "Kitabul haxh, Ebuabe Ehkam el asherah, kapitulli 152, hadithi 16.

tubimet që kalojnë me përgojime janë shumë të ngrohta dhe të ëmbla.

Dashuria e vetvetes dhe dashuria për këtë botë, që është rrënja e të gjitha gjynaheve,⁵¹ sjell kënaqësi. *Mustaski* quhet një sëmundje, nga e cila, i sëmuri kërkon shumë ujë. ⁵² Njeriu që vuan me këtë sëmundje, ndjen kënaqësi teksa e pi atë, deri në frymën e fundit. Kështu, nëse njeriu do të ndiejë kënaqësi nga ndonjë sëmundje dhe nuk do të rendë pas mjekimit, sado që ta lajmërojnë për rrezikun që është vrasës, ai sërish nuk do ta besojë.

Nëse njeriu sëmuret me sëmundjen e adhurimit të kësaj bote dhe rendjen pas pasioneve, dashuria e kësaj bote ia ka zaptuar zemrën. Ai urren dhe ka antipati për gjithçka tjetër veç kësaj bote dhe asaj që gjendet në të. Ai ushqen armiqësi në lidhje me Zotin, me njerëzit e Zotit, me profetët, me të dashurit e Zotit (eulijatë) dhe me melekët e Zotit (melaikitullah). Ky njeri ndien



⁵¹ Transmetohet nga Ebi Abdilahi (paqja qoftë mbi të!) i cili ka thënë: “Kreu i të gjitha mëkateve është dashuria e kësaj bote.” “Usulul Kafij”, vëll. 4, f. 2, “Kitab Ijman ue Kufr”, “Bab Hubbud Dunja uel hirsu alehha”, hadithi 1. ‘Usulul Kafij”, vëll. 3, f. 197, “Kitab Iman ve Kafer”, “Bab Dhemmud dunja uez zuhd fijha”, hadithi 11, Biharul Enuar, vëll. 70, f. 1 dhe vëll. 74, f. 178.

⁵² Mustaski: personi që është i sëmurë me sëmundjen e Istiska-së (hidropizisë, trupazisë). Istiska “Hidropizi” quhet një sëmundje, nga e cila, i sëmuri kërkon shumë ujë. Fjalori Muin, poshtë fjalës “musteski’ dhe “istiska”.



urrejtje dhe armiqësi edhe kur melekët, me urdhër të Zotit të Madhëruar, vijnë për t'i marrë shpirtin. Ai ndien thellësisht urrejtje dhe neveri, sepse e shikon që Zoti dhe melekët e Zotit (melaiketullah) duan ta ndajnë nga dëshira e tij (dynjaja). Ka mundësi që ai njeri të shkojë nga kjo botë duke urryer dhe duke ndier armiqësi për Zotin e Madhëruar.

Një njeri i shquar nga qyteti i Kazvinit, trasmeton: *“Shkova pranë një burri që po vdiste. Në çastet e fundit të jetës, hapi sytë dhe tha: ‘Atë padrejtësi që më ka bërë Zoti, nuk ma ka bërë askush, sepse me shumë mundime dhe lot gjaku i kam edukuar e i kam rritur këta fëmijë, kurse tani Ai më ndan nga ata. A ka padrejtësi më të madhe se kjo?’”*

Sikur njeriu të mos e pastrojë shpirtërisht veten dhe sikur të mos e nxjerrë nga zemra dashurinë për dynjanë, duhet patur frikë se kur të vdesë, shpirti i tij mund të dorëzohet me një zemër që vërshon nga inati dhe mëria ndaj Zotit dhe ndaj të dashurve të Tij. Vallë, ky njeri i shfrenuar është më i nderuari i krijesave apo është e keqja dhe sherri i krijesave? **“Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”**⁵³

Në këtë sure ka përjashtuar vetëm besimtarët (mu'minët) që kanë vepra të mira dhe “vepër e mirë” (amelu salih) është një vepër, e cila pajtohet me shpirtin.

⁵³ Sure “Asr”, ajeti 1-3

Por shikon që shumë nga veprat e njeriut, pajtohen me trupin. Njëkohësisht, nuk është vënë në funksion “Teuasi” (këshillimi). Sikur të ndodhë që dashuria e kësaj bote dhe dashuria për veten, të triumfojnë mbi ju, të mos lejojnë që të perceptoni realitetin, që të bëni të sigurtë veprimin tuaj për Zotin, t’ju pengojnë juve të këshilloni për të vërtetën, atëherë jeni në humbje (khusran) ; Jeni duke humbur si këtë botë, ashtu edhe Botën Tjetër, sepse keni humbur rininë e gjithashtu, jeni privuar nga begatitë e Xhenetit, nga privilegjet e Botës Tjetër dhe të kësaj bote. Të tjerët, edhe sikur të mos kenë udhë për në Xhenetin e Zotit dhe t’i jenë mbyllur dyert e mëshirës hyjnore dhe të qëndrojnë përherë në zjarrin e skëterrës, të paktën kanë këtë botë (dynjanë), shijojnë përfitimet e kësaj bote. Po ju, çfarë keni?

Ruhuni nga dashuria për këtë botë dhe dashuria për veten. Thuhet që e gjithë përpjekja e djallit është për t’u rrëmbyer besimin.⁵⁴

Të gjitha mjetet dhe përpjekjet e tij të përmotshme dhe të përditshme janë që të mund të rrëmbejnë besimin e njeriut. Nuk na e dokumenton kush që besimi juaj do



⁵⁴ (djalli tha: Meqë Ti më bërë rrugëhumbur, edhe unë do ti pengoj (robt) njerzit e Tu nga rruga e drejtë.) sure Araf, ajeti 16 . Në tefsirin e Ali ibn Ibrahimit, poshtë ajetit 17 të sures “A’raf”, është përmendur: “Nëse individët ecin në rrugën e udhëzimit, djalli përpiqet që t’i nxjerrë ata nga rruga e fesë.” “Tefsiri Ali ibn Ibrahim” vëll. 1, f. 224, “Tefsiri Burhan”, vëll. 2, f. 5.



të mbetet i palëkundshëm. Ndoshta besimi na është “Musteuda”⁵⁵ dhe në fund djalli t’ua marrë atë e të shkoni nga kjo botë duke urryer Zotin e Madhëruar dhe të dashurit e Tij.

67

Gjatë gjithë jetës e jetoni me begatitë hyjnore të ulur në krye të sofrës së Imamatit të kohës (Imam Zamani) (*paqja qoftë mbi të!*) dhe në fund, Zoti mos e dhëntë, e dorëzoni shpirtin pa besim dhe në armiqësi me kujdestarin e begatisë së Tij. Përpiquuni, që lidhjen dhe dashuri për këtë botë, t’a ndërprisni.

Kjo botë, me gjithë shkëlqimin e saj, nuk ia vlen aspak të dashurohet. Çfarë keni ju nga kjo botë, që ta lidhni zemrën me të? A jeni ju, kjo foltore, ky mihrab, kjo shkollë apo thesari i shtëpisë? A është e drejtë që të rivalizoni me njëri-tjetrin, të krijoni mosmarrëveshje, ta degjeneroni dhe ta korruptoni shoqërinë?

⁵⁵ Nga trasmetimet e rrëfyera nga Ehi Bejti (*paqja qoftë mbi ta!*) poshtë ajeti 98 të sures “En’am”: *Femustekarun ue musteudaun*, besimi i individëve është ndarë në dy lloje: i palëkundur (thabit) dhe i zhveshur (fals-arijeti). Kështu kemi trasmetimin e Muhamed ibn El Fadl nga Musa ibn Xha’fer (*paqja qoftë mbi të!*) që ka thënë: Ajo që është nga “besimi mustekirun” qëndon e palëkundur deri në ditën e Kiametit, ndërsa ajo që është nga “besimi musteudaun”, Zoti e merr atë para vdekjes. “Tefsiri Ajashi, vëll. 1, f. 401. Në Nehxhul Belagah, po ashtu thuhet: “Një pjesë e besimit është ngulitur në zemra, ndërsa një pjesë tjetër është zhveshur midis zemrave dhe kraharorëve derisa të vijë vdekja.” Nehxhul Belagah, “Ligjërata” 231.

Edhe sikur të keni një jetë në mirëqenie dhe luksoze, pas mbarimit të jetës do të shihni që ka kaluar si një ëndërr e këndshme, por pasojat dhe përgjegjësitë e saj do t'u zënë. Kjo jetë, në dukje e ëmbël, çfarë vlere ka përballë dënimit të pambarimtë? Në fund, të apasionuarit pas kësaj bote, që mendojnë se e kanë patur në dorë këtë botë dhe gëzojnë nga të gjitha shijimet dhe përfitimet e saj, i ka pllakosur neglizhenca dhe e kanë gabim.

Cilido qoftë ai që e shikon këtë botë nga deriça dhe imagjinon se kjo botë është vetë ajo që ai ka, kjo botë trupash është më e gjerë nga ç'imagjinon njeriu se ka futur në dorë, se e ka zbuluar dhe se e shëtitur atë.

Kjo botë me të tëra këto pajime është përmendur në trasmetimin: Te Zoti i Madhëruar, midis gjallesave që ka krijuar dhe që jemi njoftuar për to, nuk ka krijuar ndonjë gjallesë që të jetë më e urryer tek Ai se sa dynjaja (kjo botë) dhe që kur Zoti e ka krijuar dynjanë, nuk e ka vështruar atë me mëshirë.⁵⁶, prandaj duhet parë se si është Bota Tjetër, të cilën Zoti e ka vështruar me mëshirë. Ç'është "miniera e madhështisë", në të cilën e ka futur njeriun? Njeriu është tejet i vockël për ta kuptuar se ç'është "miniera e madhështisë".

Nëse ju pastroheni dhe e bëni të sinqertë nijetin dhe pikësynimin tuaj, e bëni të mirë edhe punën tuaj. Nxirreni nga zemra dashurinë për veten dhe dashurinë

⁵⁶ Biharul Enuar, vëll .70, f. 110, "Kitab ijman ve Kufr", kapitulli 122, hadithi 109.





për postin e kështu do t'ju presin pozita dhe grada larta. Përballë pozitës që është marrë parasysh për njerëzit punëmirë të Zotit, nuk vlen asnjë qindarkë e gjithë bota dhe çka ka në të, me ato manifestime gënjeshtare të saj. Përpiquni t'ia arrini këtyre gradave të larta. Mundohuni ta formoni dhe ta zhvilloni vetveten deri sa të mos u kushtoni vëmendje këtyre gradave të larta dhe të mos e adhuron Zotin për arritjen e tyre, por t'i luteni Atij, sepse e meriton adhurimin dhe madhërimin.⁵⁷

Duhet të bini në sexhde përballë Tij.

Atëherë ndodh që të grisni perdet e dritës dhe t'ia arrini “minierës së madhështisë”. Vallë, a mund t'ia arrini ju një pozite të tillë me këto punë dhe me këto vepra që keni, me këto udhë që po ndiqni? Vallë, a do të jetë i lehtë shpëtimi nga ndëshkimet hyjnore dhe arratia nga pasojat e tmerrshme dhe zjarri i

⁵⁷ Është transmetuar nga Imam Sadiku se adhurimet janë tre llojesh. Një grup e adhuron Zotin e Madhëruar nga frika dhe ky është adhurim i robve.

Një grup e adhuron Zotin e Madhëruar për të marrë shpërblim dhe ky është adhurim i mercenarëve.

Një grup e adhuron Zotin e Madhëruar nga dashuria dhe ky është adhurim i të lirëve. Ky është më i miri i të gjithë adhurimeve. Uesailush Shiah, vëll. 1, f. 45, “Ebuab Mukaddemat el ibadat: kapitulli 9, hadithi 1. “Usul” Kafi, vëll. 3, f. 131, “Kitab Imam ve Kufr”, “Bab ibadat”, hadithi 5.

skëterrës? A mos pandehni që qarjet e Imamëve të pastër dhe vajtimet e të madhit Imam Sexhad kanë qenë për mësimdhënie se ka dashur që t'i mësojë të tjerët? Ata, me gjithë pozitën e lartë që kishin, qanin nga frika e Zotit dhe e dinin se sa e vështirë dhe e rrezikshme ishte udha që kishin përballë. Ata ishin në dijeni mbi problemet, vështirësitë, peripecitë e kalimit në sirat, në njërën anë të së cilës është kjo botë kurse në anën tjetër, është Bota Tjetër dhe që kalon përmes skëterrës. Ata ishin të vetëdijshëm mbi botën e varrit, berzahut, Kiametit dhe pasojat e tyre të tmerrshme, prandaj nuk ishin të qetë kurrë, por gjithnjë i kërkonin dhe e lusnin Allahun ti mbronte nga ndëshkimet e rrepta të Botës Tjetër.

Çfarë keni menduar ju për këto pasoja të tmerrshme robëtuese dhe çfarë rrugë shpëtimi keni gjetur? Në cilën kohë doni të vini në pozitën e ndreqjes dhe të pastrimit të vetvetes?

Tani që jeni të rinj, keni energji rinie, jeni dominues të forcave tuaja dhe ende nuk iu ka vënë përfund dobësia trupore. Sikur të mos keni ndërmend të bëni formimin e vetvetes në pleqëri, kur trupin tuaj ta ketë pushtuar dobësia, plogështia dhe ftohja dhe kur ta keni humbur forcën e vullnetit, të vendimarrjes dhe të rezistencës, si do të mund ta formoni dhe ta pastroni shpirtërisht vetveten?





Në çdo frymëmarrje që bëni, në çdo hap që hidhni dhe në çdo çast që kalon nga jeta juaj, ndreqja bëhet edhe më e vështirë. Mundet që të shtohet errësira. Sa më shumë që të rritet mosha, aq më shumë shtohen këto çështje në mospërputhje me lumturinë e njeriut dhe aq më shumë pakësohet fuqia.

Pra, kur të bëheni pleq, është e vështirë që të keni sukses në fitimin e virtytshmërisë dhe të devotshmërisë. Ju nuk mund të pendoheni e të bëni teube, sepse pendesa nuk përmbushet me thënien: *“Etubu ilall-llah”*, por është e nevojshme pendesa dhe vendosmëria për braktisjen e mëkatit.⁵⁸

Nuk arrihet pendesa dhe vendosmëria mbi braktisjen e gjynahit për ata persona që kanë përgojuar dhe kanë gënjyer për pesëdhjetë vjet a shtatëdhjetë vjet. Persona të tillë janë të sëmurë deri në fund të jetës. Rinia të mos ulet dhe të presë që pleqëria t’ia zbardhë kokën. Derisa të keni energji dhe vullnet rinor, mund t’i largoni nga vetja pasionet vetjake, orekset e kësaj bote dhe dëshirat shtazore, por nëse nuk mundoheni në rini

⁵⁸ Prijësi i Besimtarëve ka thënë: *“Me të vërtetë, pendesa (istigfar) është gradë e të lartëve (il-lijin). Ajo është një emër që del në gjashtë kupime: së pari, është **pendesa** dhe së dyti, **vendosmëria dhe moskthimi në mëkat kurrë më...**”*

Nehxhul Belagah, f. 1281, “Urtësia” 409. Për më shumë informacion në lidhje me pendesën (teube) referohuni në sherh erbajin hadith (komentimi i dyzet haditheve, Imam Khomeini, hadithi 17.

për të ndrequr dhe për të formuar veten, në pleqëri puna ka mbaruar.

Sa të jeni të rinj, mendoni. Mos lejoni të plakeni dhe të plogështoheni. Zemra e të riut është e butë dhe hyjnore dhe janë të dobëta në të shkaqet e degjenerimit dhe të prishjes. Sa më shumë të rritet mosha, aq më shumë formohet rrënja e gjynahit në zemër, ashtu siç është përmendur në trasmetimin: *“Në fillim, zemra e njeriut është si një pasqyrë e kulluar dhe e ndritshme dhe për çdo gjynah që zë fill nga njeriu, mbi zemër shtohet nga një pikë e zezë,⁵⁹ derisa e nxin zemrën dhe ka mundësi që atij të mos i kalojë nata dhe dita pa bërë gjynah ndaj Zotit. Kur të arrijë në pleqëri, është ë vështirë që njeriu ta rikthejë zemrën në formën dhe në gjendjen e mëparshme.”*

Nëse ju, nuk e ndreqni veten dhe shkoni nga kjo botë me zemra të zeza, sy, veshë dhe gjuhë të ndotura me gjynah, e si do ta takoni Zotin? E, si do t'i ktheni në të ndotura dhe fëlliqësira këto amanete hyjnore, të cilat u janë dorëzuar plotësisht të pastra? Këto sy dhe këto veshë që janë në shërbimin tuaj, këto duar dhe kjo gjuhë që janë nën

⁵⁹ Është trasmetuar nga Imam Bakiri (*paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ka as një (rob) njeri, në zemrën e të cilit të mos gjendet ndonjë pikë e bardhë. Kur kryen ndonjë gjynah, aty del një pikë e zezë. Atëherë kur pendohet, i zhduket e zeza, por nëse vazhdon të bëjë gjynah, i shtohet aq shumë e zeza, saqë ia vesh dhe e mbulon të bardhën dhe kur të vishet e bardha, pronari i asaj zemre nuk rikthehet më kurrë tek mirësia dhe mirëbërja.” “Usul” Kafi, vëll. 3, f. 274, “Kitabe Iman ve Kufa”, “Bab edh dhunub” hadithi 20.





urdhrrat tuaj, këto gjymtyrë dhe organe, me të cilat jetoni - të gjitha janë amanete të Zotit të Madhëruar. Ai ua ka dhënë plotësisht të pastra e të rregullta. Po të kaplohen në gjynahe, do të ndoten. Po të ndoten me gjëra të ndaluara dhe harame, do të poshtërohen dhe këto amanete, ka mundësi që t'iu pyesin *nëse kështu është vërtet rruga dhe zakoni i mbajtjes së amanetit?!*

Pse kështu e lamë në shërbimin tuaj Ne këtë amanet? Pse kështu ishte zemra që ju dhamë? Pse kështu ishin sytë që ju dhamë? Pse kështu të ndotura dhe të pista ishin organet dhe gjymtyrët e tjera që vumë në dispozicionin tuaj? Çfarë përgjigjeje do të jepni përballë këtyre pyetjeve? E si do ta takoni Zotin tuaj me këto tradhti që i bëtë amaneteve të Tij?

Ju jeni të rinj, keni lënë rininë tuaj në këtë rrugë, e cila nuk jus jell dobi në dynja. Sikur këtë kohë të vyer dhe pranverë rinore ta vinit në funksion të rrugës së Zotit dhe të një qëllimi të shenjtë dhe të përcaktuar, nuk keni bërë dëm, por madje, është siguruar kjo botë dhe Bota Tjetër e juaja.

Por, nëse e keni shkatërruar rininë tuaj dhe jeta juaj ka shkuar kot, edhe në Botën Tjetër do të jeni rreptësisht përgjegjës dhe të qortuar. Ndërkohë, ndëshkimi i këtyre veprave dhe i këtyre akteve tuaja çoroditëse nuk do të jetë i kufizuar vetëm në Botën Tjetër.

Edhe në këtë botë do t'iu zënë për gryke problemet, mjerimet dhe hallet e rënda dhe të lloj-llojshme. Ju do të bini në vorbullën e fatit të errët.



PARALAJMËRIM TJETËR

Një e ardhme e errët dhe armiq të shumtë ju kanë rrethuar nga çdo anë dhe çdo klasë. Janë parashikuar plane djallëzore të rrezikshme, me qëllim zhdukjen tuaj dhe të shkollave fetare shkencore. Duart e kolonizimit kanë parë ëndrra shumë të thella për ju, kanë parë ëndrra shumë të thella për Islamin dhe myslimanët (në dukje me Islamin, duke u shtirur si myslimanë), kanë skicuar plane të rrezikshme për ju.

Vetëm në hijen e disiplinimit dhe të sistemimit të drejtë, mund t'i hiqni nga kryet e rrugës suaj këto degenerime dhe probleme dhe të neutralizoni planet kolonizuese. Unë, tani po kaloj ditët e fundit të jetës time dhe herët a vonë, do të ndahem nga mesi juaj, por parashikoj një të ardhme të errët dhe ditë të zeza për ju.

Nëse nuk e ndreqni veten, nuk pajiseni dhe nuk bëni që në çështjet tuaja mësimore dhe jetësore të dominojë rendi dhe disiplina, në të ardhmen, do të jeni të destinuar të zhdukeni. Mendoni ndonjë gjë përpara se armiku të kontrollojë të gjitha çështjet tuaja fetare dhe diturore. Zgjuhuni dhe ngrihuni në këmbë!

Në fazën e parë, dilni në pozitën e pastrimit shpirtëror dhe të ndreqjes së vetvetes. Vini rregull dhe disiplinë në shkollat fetare shkencore. Mos lejoni të vijnë të tjerët dhe t'ua sistemojnë shkollat fetare. Mos lejoni që





armiqtë të vënë dorë mbi shkollat fetare me preteksin që këta nuk janë të merituar e nuk janë kompetentë.

Mos lejoni që në emër të rendit dhe të reformave të degjenerojnë shkollat fetare dhe t'iu vënë nën kontrollin e tyre. Mos u lini shkas në dorë. Sikur ju të disiplinoheni, sikur të jenë në rregull të gjitha drejtimet tuaja, të tjerët nuk ju lakmojnë më. Pastrojeni shpirtërisht veten, përgatituni për të parandaluar degjenerimet që kërkojnë t'ju qasen, përgatitni shkollat fetare tuaja përballë të papriturave që ju afrohen.

Kolonizatorët duan që ta zhdukini të gjithë prestigjin e Islamit. Ju duhet të bëni qëndresë përballë kësaj dhe nuk mund të bësh rezistencë duke dashur veten, postin dhe mendjemadhësinë. Dijetari i keq, dijetari i përkushtuar pas kësaj bote, dijetari që mendon se si të ruajë postin dhe kryesinë, nuk mund të përballlet me armiqtë e Islamit.

Dëmi i tij është më i madh se sa i të tjerëve. Bëni hap hyjnor, merrni nga zemra dashurinë për këtë botë e atëherë mund të përballeni. Që tani edukojeni dhe kaliteni në zemrën tuaj shprehjen: *“Unë duhet të punoj për Islamin derisa të vdes”*.

Mos gjeni justifikim për veten. Duhet t'ju ngacmojë brenga për të ardhmen e Islamit. Duart e kolonizimit tremben nga njeriu. Kolonizatorët që duan të grabisin gjithçka tonën, nuk lejojnë që në universitetet tona fetare dhe shkencore të edukohet njeriu.

Ju jeni të detyruar ta formoni vetveten. Bëhuni njerëz të plotësuar (insane kamil) dhe qëndroni përballë kompleteve të liga të armiqve të Islamit. Sikur të mos përballeshit me goditjet që i bëhen çdo ditë shtetit të Islamit, edhe vetë do të zhdukeshit; edhe rregullat dhe ligjet e Islamit do t'i zhdukni. Ju do të jeni përgjegjës.

Ju dijetarë dhe ju, o myslimanë, jeni përgjegjës. Në krye jeni ju dijetarët dhe nxënësit dhe myslimanët e tjerë pas jush⁶⁰

Zoti i Madhëruar e ruajtë Islamin, myslimanët dhe shtetet islame nga e keqja e të huajve! Zoti e shkurtoftë dorën e kolonizimit dhe të tradhtarëve të Islamit nga shtetet islame dhe nga shkollat fetare shkencore!

Zoti u dhëntë sukses dijetarëve të Islamit dhe autoriteteve të larta të referencës (merxha udham) në mbrojtjen ndaj ligjeve të shenjta të Kur'anit fisnik dhe në përparimin e idealeve të shenjta islame. Zoti i bëftë të paprekshme dhe të mbrojtura shkollat fetare shkencore nga grabitja dhe ndikimi i armiqve të Islamit dhe nga duart kolonizuese.

Brezit të ri dhe të gjithë myslimanëve Zoti i dhëntë suksesin e formimit të vetvetes dhe të pastrimit të shpirtit! Zoti e çliroftë ymetin islam nga gjumi i neglizhencës, nga plogështia, nga ligështia dhe nga amullia mendore! **“Zoti ynë! Na pajis me durim, na forco këmbët tona dhe na ndihmo kundër këtij populli jobesimtar!”**⁶¹ O Zoti ynë. Na e prano lutjen.

⁶⁰ Aualij Lealij, kapitulli 8, hadithi 3, vëll. 1, f. 129, El Xhamiu es Sagir, vëll. 2, f 45- 95.

⁶¹ Sure “Bekare”, 250.





FJALË TË ZGJEDHURA

Të gjitha cilësitë njerëzore të pëlqyera fshihen në shkëputjen e plotë për tek Allahu.



Vërtet, dynjaja me gjithë bukuritë dhe hijeshitë e saj nuk është as sa grimca e vendit të përgatitur për robtë punëmirë të Allahut.

Vërtet, kjo dynja me gjithë pamjen e saj magjepsëse është më e keqja që ta meritojë dashurinë.

Çfarë vlere ka kjo jetë e zhdukshme dhe me pamje mashtruese përballë dënimit të përhershëm?

Drejtimi kah tjetër kush, përveç Allahut, e mbulon njeriun me errësirë.

Të gjitha çështjet e kësaj jete, nëse shkaktojnë tërheqje të njeriut kah dynjaja dhe e çojnë atë në pavëmendshmëri ndaj Allahut të Madhëruar, sigurisht që ato sjellin mbulesa të errëta.

Jini me partinë e Allahut dhe largohuni prej bukurive të jetës së dynjasë dhe prej pamjeve të saj mashtruese.

Vërtet dijetari i fesë që e konsideron veten e tij prej pasuesve dhe ndjekësve të Ali ibn Ebi Talib (pagja qoftë mbi të!) nuk mund të mashtrohet prej bukurive të dynjasë.

Vërtet, të gjitha mosmarrëveshjet që nuk kanë një qëllim të caktuar e të shenjtë, kthehen tek dashuria për këtë dynja.

Sigurisht, Allahu i dërgoi profetët për ndërtimin e njeriut, për edukimin e tij dhe për largimin e tij nga të këqijat, nga ndytësitë e shthurjet. Allahu i dërgoi profetët për inkurajimin e njeriut për t'u pajisur me morale dhe sjellje të mira.

Nëse hidhni hapa për hir të Allahut, s'ka dyshim se Allahu i Madhëruar, Ndryshuesi i zemrave, i bën zemrat të anojnë drejt jush.

Mos u mobilizoni për askënd përveç Allahut Absolut.





Vërtet, zemra e njeriut është si pasqyra e pastër dhe ndriçuese, por ajo përlyhet si rezultat i dhënies së pas dynjanë dhe prej gjynaheve të shumta.

79

Si mund të qëndrohet pranë të Vërtetit të Lartë dhe si mund të hyhet në mikëpritjen e Sunduesit të sunduesve, i Cili është miniera i madhështisë, me gjithë ato papastërti shpirtërore, morale të këqija dhe gjynahe të dukshme e të padukshme?



Jini të devotshëm ndaj Allahut, frikësojuni fundit të çështjeve dhe zgjahuni nga pavëmendshmëria.

Jini largpamës, peshojini fundin e çështjeve, kujtojini fundet e rrezikshme me të cilat do të përballeni, kujtojeni dënimin e varrit, botën e Barzahut (bota mes kësaj jete dhe Jetës Tjetër) dhe tmerret që e pasojnë atë.

Vërtet, zjarret e Xhehenemit tërbohen prej punëve dhe veprave të shëmtuara të njeriut.

Sikur njeriu të mos vepronte vepra që e ndezin zjarrin e Xhehenemit, ai do të ishte i fikur. Vërtet, e brendshmja e kësaj dynjaje është Xhehenem. Të interesuarit për këtë jetë është interesim për Xhehenem dhe lojë me zjarrin e tij.

Ajo çfarë do të korrë njeriu në Ahiret është frut i të mbjellës së tij në dynja.

Mendoni për fundin e çështjeve tuaja, para se të humbasë (të zhduket) koha nga duart tuaja.

Ju, o të rinj e të reja, po ecni drejt pleqërisë dhe ne të plakurit ecim drejt vdekjes.

Vërtet, çdo frymëmarrje që kryeni, çdo hap që hidhni dhe çdo moment që ikën prej veprave tuaja, e shton më shumë vështirësinë e ndreqjes suaj. Ndoshta shtojnë edhe errësirën e zemrës, krenarinë, mburrjen dhe mendjemadhësinë.

Përderisa zotëroni vendosmërinë e rinisë dhe vullnetin e saj, ju mund të shpëtoni nga egoja e unit, nga dëshirat për këtë botë dhe nga epshet shtazore.

Vërtet, zemra e të riut është delikate dhe e dëlirë dhe shtytësit e devijimit tek ai janë të dobët. Mirëpo, me përparimin e moshës së njeriut, rrënjët e gjynahit forcohen, derisa ato bëhen të pamundura që të shkulen.

Pendimi i vërtetë nuk realizohet vetëm duke shprehur thënien "etubu ilallah" (pendohem tek Allahu),





por duhet të realizohet pendimi dhe vendosmëria e lënies së gjynaheve.

Jini të dashur ndaj njerëzve dhe bashkëpunoni me ta me të mirë. Shikojini ata me shikimin e dhembshurisë dhe të dashurisë.

81

Bëni mirësi për robtë punëmirë të Allahut.

Ai që nuk i ruan myslimanët e tjerë me dorën, me gjuhën dhe me shikimin e tij, në të vërtetë, nuk është mysliman.

T'i bësh keq robve të Allahut është njëlloj si t'i bësh keq Allahut.

Ai që i nënshtrohet egos së vet dhe pason shejtanin, dalëngadalë, merr ngjyrën e tij.

Banorët e Ahiretit jetojnë në paqe dhe dashuri. Zemrat e tyre janë të tejmbushura me dashurinë për Allahun dhe për robtë e Tij.

Dashuria e robve të Allahut është hija e dashurisë së Allahut.

Kur'ani i shenjtë është amaneti i madh i Allahut dhe dijetarët e fesë janë besnikët e Allahut.

Detyra e dijetarëve është shumë e rrezikshme dhe përgjegjësia e tyre është më e madhe se sa përgjegjësia e njerëzve të tjerë.

Në një hadith të begatë thuhet se kur shpirti është në kohën e daljes, për dijetarin nuk ka vend për pendim.

Nëse dijetari devijon, edhe bashkësia devijon. Ai e tërheq atë në shkatërrim.

Nëse dijetari është i edukuar dhe ruajtës i moraleve dhe i sjelljeve islame, ai do të punojë për edukimin e shoqërisë dhe për udhëzimin e saj.

Dija në shpirtat e paedukuar nuk është gjë tjetër, veçse mbulesë errësire.

Dija është dritë. Mirëpo në mendjen e errët dhe në zemrën e prishur (devijuar) dija e zgjeron më shumë rrethin e errësirës.

Dija që e afron njeriun tek Allahu, në zemrat e lidhura me këtë jetë, bëhet shkak i largimit të tyre nga Arshi i Allahut.

Edhe dija e teuhidit (monoteizmit), nëse nuk është për hir të Allahut, bëhet mbulesë errësuese.





Nëse njeriu nuk i nxjerr të këqijat nga brendia e tij, sado që të mësojë, nuk ka dobi, por i sjell dëme atij.

Dijetari i prishur e drejton botën për në shkatërrim.

83

Duke u folur nxënësve të dijes, (imam Komeini ka thënë): Nëse nuk mësoni, atëherë është haram për ju që të qëndroni në shkollat fetare.

Për çdo hap që hidhni për kërkimin e dijes, hidhni edhe një hap për mposhtjen e epsheve, për forcimin e fuqive shpirtërore, për fitimin e moraleve të mira dhe për fitimin e devotshmërisë.

Nëse nuk ka sinjeritet dhe qëllim për afrimin tek Allahu, këto dije nuk kanë dobi.

Përpiquni ta ndreqni dhe ta edukoni veten tuaj, para se të zbrisni në shoqëri.

Kur të largoheni nga qendrat e dijes – hauzet -, ju duhet të jeni të edukuar, me qëllim që të jeni të aftë t'i edukoni edhe njerëzit dhe t'i ndreqni ata.

Nëse një njeri devijon dhe e braktis Islamin për shkak të veprave dhe të sjelljeve tuaja jo të mira, dijeni se keni bërë një gjynah të madh.

Mos e caktoftë Allahu që shoqëria të marrë shembull dhe model një njeri, para se të edukojë veten e tij dhe të fitojë pozitë në mesin e njerëzve, ai do të humbasë veten e tij.

Edukoheni veten tuaj para se t'u merren frerët e zgjedhjes nga duart tuaja.

Zbukurohuni me moral të mirë dhe largohuni nga moralet e këqija. Singëriteti të jetë udhëheqësi juaj në studime dhe në hulumtime, që të afroheni tek Allahu.

Nëse nuk gjendet qëllimi i pastër në vepra, njeriu largohet nga Arshi i Allahut.

Përpiquni ta përhapni disiplinën dhe rregullin në hauzatet e dijes.

Duart e kolonizatorëve janë zgjatur për zhdukjen e Islamit. Është detyra juaj që të përballeni me intrigat e tyre.





Nuk mund të ketë rezistencë me praninë e vetëpëlqimit, të mendjemadhësisë dhe të mburrjes.

85

Dijetari i keq, dijetari i dhënë pas dynjasë dhe dijetari që mendon vetëm për të ruajtur postin dhe pozitën, nuk mund të luftojë kundër armiqve të Islamit.



Hidhini hapat për Allahun dhe nxirreni dashurinë për këtë botë nga zemra. Atëherë do të jeni fitimtarë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Parathënie.....	5
Rekomandim drejtuar hauzeve të dijes.....	11
Rekomandim kushtuar nxënësve.....	12
Rëndësia e edukimit të vetvetes.....	18
Paralajmërim hauzeve.....	28
Përkujdesjet Hyjnore.....	38
Disa pika nga munaxhati Shabanije.....	42
Mbulesat e njeriut.....	54
Dija dhe besimi.....	57
Hapi i parë drejt pastrimit shpirtëror.....	62
Paralajmërim tjetër.....	74
Fjalë të zgjedhura.....	77
Përmbajtja e lëndës.....	86





نام کتاب: **جهاد النفس**



نویسنده: **امام خمینی (ره)**

تیرانا: **2014**

نام کتاب: مبارزه با نفس یا جهاد اکبر

نویسنده: امام خمینی (ره)

مترجم: ردیس شکو

ویرایش ادبی: لیسدا رامای

مقابله: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت نسیم

تیرانا: 2014

